

PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE BASHKËPUNIMI MES SEKTORIT CIVIL DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI



PJESËMARRJA E QYTETARËVE DHE BASHKËPUNIMI MES SEKTORIT CIVIL DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI

Ky doracak është përgatitur me mbështetje të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e doracakut përjashtimisht është përgjegjësia e Qendrës për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO) dhe Partnerëve Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti (PSh) dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

BOTUESI:

Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO)
Rr. Dallmatinska 78
20000 Podgoricë
Tel/fax: 020/219 120, 219 121, 219 122, 219 123
E-mail: crnvo@crnvo.me
www.crnvo.me

TITULLI I PUBLIKIMIT

Pjesëmarrja e qytetarëve dhe bashkëpunimi mes sektorit civil dhe vetëqeverisjeve lokale në Mal të Zi dhe Shqipëri

PËR BOTUESIN:

Ana Novaković

PËRGATITËN

Llidi Knezheviq, Stefa Axhiq, Blerina Guga, Ariola Agolli

PËRGATITI PËR SHTYP DHE SHTYPI:

Studio Mouse, Podgorica

TIRAZHI:

500

Podgoricë, Qershor 2013

Përmbajtja

Parathënie	5
1. VËREJTJET HYRËSE	7
1.1. Rëndësia e pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimit të politikave lokale dhe e bashkëpunimit mes sektorit civil dhe vetëqeverisjeve lokale	7
2. MEKANIZMAT E PJESEMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË NIVELIN LOKAL NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI.....	9
2.1. Korniza normative e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal në Mal të Zi	9
2.1.1 Iniciativa.....	14
2.1.2 Iniciativa qytetare	14
2.1.3 Bashkim qytetarësh	15
2.1.4 Referendumi.....	15
2.1.5 Peticioni dhe ankesa qytetare.....	16
2.1.6 Format tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në punën e vetëqeverisjeve lokale	17
2.1.7 Standardet e veprimit të vetëqeverisjes lokale drejt qytetarëve	17
2.1.8 Format e bashkëpunimit dhe strukturat e bashkëpunimit mes vetëqeverisjeve lokale dhe organizatave joqeveritare në Mal të Zi	18
2.2. Korniza normative e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal në Shqipëri	19
2.2.1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	20
2.2.2. Ligje dhe rregullore që ndikojnë te drejtën e organizimit	21
2.2.3. Korniza Ligjore Për Lirinë e Shprehjes	22
2.2.4. Korniza ligjore për te drejtën e Informimit	23
2.2.5. Ligjet që ndikojnë tek Negociatat.....	24
3. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BASHKËPUNIMIT MES ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI.....	26
3.1 Praktikak më të mira të bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile dhe vetëqeverisjeve lokale në Mal të Zi	26
3.2 Praktikak më të mira të bashkëpunimit mes qytetarëve dhe vetëqeverisjeve lokal në Shqipëri	35
4. REKOMANDIMET PËR AVANCIMIN E BASHKËPUNIMIT MES SHOQËRISË CIVILE DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI	45
5. BURIMET DHE LITERATURA.....	47



Parathënie

Publikimi “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi dhe Shqipëri” është rezultati i projektit “Shoqëria civile dhe vetëqeverisja lokale në përfundimin e kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe Mal të Zi” që Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO) në partneritet me Qendrën për ndryshime dhe zgjidhjen e konflikteve nga Shqipëria (PARTNERS) ia ka filluar në Maj të vitit 2012. Projekti njëvjeçar i bashkëpunimit ndërkufitar të Malit të Zi dhe Shqipërisë u financua nga Bashkimi Evropian, nga komponenti i dytë i Instrumentit për ndihmë para-aderimi 2007 – 2013. Qëllimi kryesor i projektit ishte shkalla më e lartë e integritit, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit të shoqërisë civile në fushën e përfundimit të kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe në Mal të Zi. Përveç këtij, projekti ka synuar ngritjes së nivelit të shkëmbimit të ideve dhe dijenive, si dhe bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile, grupeve shoqërore dhe vetëqeverisjes lokale nga dy vendet.

Në përputhje me qëllimet e projektit janë zbatuar aktivitetet për përfaqësuesit e organizatave joqeveritare individët aktiv dhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale nga katër qytete malazeze (Tivar, Danilovgrad, Plavë dhe Berane) dhe katër qytete shqiptare (Koplik, Bushat, Vau i Dejës dhe Dajç). Duke marrë pjesë në aktivitetet të projektit, përfaqësuesit e vetëqeverisjeve lokale dhe organizatave joqeveritare nga dy vendet kanë pas mundësi t’i përforcojnë kapacitetet e veta në fusha të përfaqësimit publik, mobilizimit të komunitetit, inkluzionit social. Përveç këtyre, pjesëmarrësve të projektit u mundësua zgjerimi i dijenive të tyre mbi mekanizmat dhe modelet e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal, si dhe mbi mënyrat përmes të cilave mund t’i zbatojnë monitorimin e zbatimit të vendimeve të miratuara dhe politikave publike në përgjithësi. Poashtu, një nga rezultatet kryesore të këtij projekti janë edhe zhvillimi i modeleve të mira të bashkëpunimit dhe komunikimit mes organizatave joqeveritare, formave joformale të bashkimit të qytetarëve dhe vetëqeverisjeve lokale në Mal të Zi dhe në Shqipëri.

Ky publikim paraqet mbindërtimin e dijenive që përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, organizatave joqeveritare dhe individët aktiv në shoqëri të veta e kanë përvetësuar gjatë zbatimit të këtij projekti, por edhe një mjet më shumë i informimit për ata që nuk ishin drejtpërdrejtë të kyçur në vetë realizimin e projektit. Publikimi është i qëlluar për përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale, por edhe për të gjithë qytetarët që nuk kanë dëshirë të mbesin vetëm shikuesit pasiv, por të marrin pjesë aktive në punën e vetëqeverisjes lokale, dhe duke pas para sysh karakterin edukativ të publikimit, shpresojmë se do të jetë i dobishëm edhe për gjithë të tjerët që janë të interesuar.

Publikimi “Pjesëmarrja qytetare dhe bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi dhe Shqipëri” përbëhet nga tri pjesë:

- Mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes;
- Shembujt e praktikës së mirë të bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale; dhe
- Rekomandimet për avancimin e bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale.

Rëndësia e posaçme e këtij publikimi pasqyrohet në faktin se gjitha pjesët tematike janë të trajtuara në nivelin e dy vendeve – Malit të Zi dhe Shqipërisë, ashtu që lexuesit do t’ a kanë mundësinë që t’ a bëjnë një lloj të krahasimit në lidhje me fushat e përmbajtjes. Qëllimi i publikimit është edhe të kontribuoj informimit sa më të gjerë të qytetarëve mbi këto çështje, çfarë drejtpërdrejtë do të ndikojë tek pjesëmarrja më e madhe e qytetarëve në realizimin e vetëqeverisjes lokale. Qytetarët e informuar, aktiv dhe të përgjegjshëm janë themeli i çdo shoqërie demokratike, prandaj është e domosdoshme që të njoftohen me të drejtat e veta në procesin e vendimmarrjes, por edhe me obligimet që vetëqeverisja lokale i ka në informimin dhe në përfshirjen e qytetarëve në punën e vetë. Përpos pjesës teorike, kemi pas dëshirë të tregojmë edhe si bashkëpunimi mes shoqërisë civile dhe vetëqeverisjes lokale realizohet në praktikë, ashtu që me përkrahjen e zyrtarëve të vetëqeverisjes lokale që janë përgjegjës në pyetësorin tonë, kemi arritur t’ a bëjmë një pamje të formave më të suksesshme të bashkëpunimit. Në fund mund t’ i shikoni edhe rekomandimet që paraqesin pikënisjen e mirë si për qytetarët ashtu edhe për vetëqeverisjen lokale për avancimin e bashkëpunimit të tyre.

1. VËREJTJET HYRËSE

1.1. RËNDËSIA E PJESËMARRJES QYTETARE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES DHE ZBATIMIT TË POLITIKAVE LOKALE DHE E BASHKËPUNIMIT MES SEKTORIT CIVIL DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE

E drejta e qytetarëve për pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal paraqet principin e rregullimit demokratik të shtetit dhe parakushtin kryesor për punën transparente dhe përgjegjëse të vetëqeverisjeve lokale. Ajo nënkupton çdo aktivitet të qytetarëve me qëllim të kyçurit në procesin e miratimit dhe zbatimit të politikave publike në nivelin lokal (paraqitja e kërkesave për qasjen e lirë në informacion, nënshkrimi i peticioneve, ardhja në bashkime të qytetarësh nëpër bashkësi lokale, parashtrimi i iniciativave për zgjidhjen e problemeve që e prekin popullsinë lokale, aksionet e qarta dhe format e ndryshme të protestave përmes të cilëve qartazi tregohet puna e parregullt e organeve të vetëqeverisjes lokale, etj.). Duhet theksuar se e drejta e qytetarëve për pjesëmarrjen në qeverisje në nivelin lokal nuk paraqet një të drejtë të posaçme të garantuar me Kushtetutë. Kjo e drejtë rrjedh nga parimet e përgjithshme të renditjes demokratike politike dhe nga të gjitha drejtat tjera të garantuara me Kushtetutë, siç janë e drejta mbi vetëqeverisjen lokale, e drejta e qasjes së lirë në informacion, liria e shtypit dhe formave të tjera të informimit publik, liria e organizimit, etj.

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e miratimit dhe zbatimit të politikave publike (lokale dhe kombëtare) është pjesë përbërëse e demokracisë pjesëmarrëse që se bashku me demokracinë përfaqësuese paraqet një themel të shoqërisë demokratike bashkëkohore. E drejta e qytetarëve për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes në nivelin lokal nuk paraqet një të drejtë të posaçme të garantuar me Kushtetutë. Kjo e drejtë rrjedh nga parimet e përgjithshme të renditjes demokratike politike dhe nga të gjitha drejtat tjera të garantuara me Kushtetutë, siç janë e drejta mbi vetëqeverisjen lokale, e drejta e qasjes së lirë në informacion, liria e shtypit dhe formave të tjera të informimit publik, liria e organizimit, etj.

Ideja e pjesëmarrjes qytetare ose participimit qytetar në proceset e vendimmarrjes e ka një rëndësi të posaçme në nivelin lokal të komunës ose qytetit. Vetëqeverisja lokale është adresa e parë për çdo qytetar, se qytetarët në mënyrë më të drejtpërdrejtë e përjetojnë pikërisht komunitetin e vetë lokal. Relacioni qytetari – pushteti pa dyshim është më i afërt në këtë nivel të pushtetit. Qytetarët pikërisht në vetëqeverisje lokale kanë mundësinë që më së shumti të ndikojnë tek ndryshimi dhe zbatimi i vendimeve të miratuara. Duke konsideruar se qytetarët janë më të njoftuar me problemet në komunitetet e veta lokale, aq më tepër janë referent t' i kërkojnë dhe t' i propozojnë zgjidhjet që do të sjellin deri tek eliminimi i atyre problemeve.

Qytetarët mund të marrin pjesë në vendimmarrje në komunitete të veta lokale në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesve. Për shembull, kur qytetarët në bashkime të qytetarëve diskutojnë


dhe japin propozimet mbi çështjet nga kompetencat e një organit komunal, atëherë bëhet fjala mbi demokracinë e drejtpërdrejtë. Por, kur këshilltarët në kuvendin lokal në emër të qytetarëve që i kanë zgjedhur votojnë për një vendim, atëherë bëhet fjala për demokracinë përfaqësuese.

Përfitimet që pushtetet lokale i kanë nga pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin dhe implementimin e politikave publike janë të shumta. Para të gjithave, ato vendime të pushteteve lokale që u miratuan me pjesëmarrje të qytetarëve në mënyrë adekuate e kanë legjitimitetin më të madh dhe janë më të qëndrueshme. Me ngritjen e participimit qytetar në kryerjen e punëve njëkohësisht ngritët edhe besimi mes qytetarëve dhe pushtetit. Me pjesëmarrjen e vetë në miratimin dhe zbatimin e vendimeve qytetarët pa dyshim janë në pozitë që të japin kontributin e vetë të rëndësishëm ngritjes së transparencës së punës së vetëqeverisjeve lokale. Në këtë mënyrë njëkohësisht zhvillohet një shoqëri civile aktive e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të angazhuar në komunitete të veta. Me pjesëmarrje në krijimin dhe implementimin e vendimeve, qytetarët nga votuesit joaktiv dhe jo mjaft të interesuar bëhen subjektet aktiv politik. Në këtë mënyrë qytetarët e marrin përsipër përgjegjësinë për marrjen e vendimeve politike, vendosin mbi cilësinë e shërbimeve publike, zgjidhin problemet e përcaktuara në komunitete të veta dhe u ndihmojnë vetëqeverisjeve lokale për t' i identifikuar ato probleme.

2. MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË NIVELIN LOKAL NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI

2.1. KORNIZA NORMATIVE E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË NIVELIN LOKAL NË MAL TË ZI

Korniza normative për pjesëmarrjen qytetare ose participimin qytetar në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal në Mal të Zi përfshinë aktet e shumta ligjore. E drejta për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrjen në nivelin lokal, rregulluar nga aktet më të larta drejt akteve më të ulëta ligjore, në mënyrë skematike mund të shfaqet siç vijon:



Para së gjithash, *Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale*¹ që u miratua nga Këshilli i Evropës në vitin 1985, definon vetëqeverisjen lokale si një grup të institucioneve lokale që e kanë të drejtën por edhe obligimin që qytetarëve të komunitetit të caktuar lokal t’i mundësojnë që, drejtpërdrejtë apo përmes përfaqësuesve të vetë, t’i qeverisin punët publike të caktuara në mënyrë relativisht të pavarur me përgjegjësi të vetë dhe për interes të vetë. Të drejtën mbi vetëqeverisjen lokale qytetarët e realizojnë me qeverisjen e drejtpërdrejtë ose indirekte të punëve publike nga interesi i drejtpërdrejtë

¹ *Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale* <http://www.uom.co.me/wp-content/uploads/2010/05/Evropska-povelja-o-lokalnoj-samoupravvi.pdf>

dhe i përbashkët për popullsinë lokale. Në vitin 2008 Mali i Zi e ka ratifikuar Kartën Evropiane e vetëqeverisjes lokale që hyni në fuqi më 01.01.2009. Kështu dispozitat dhe rregullat e përmbajtura në Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale janë bërë pjesë përbërëse e renditjes së brendshme ligjore, e kanë primatin mbi legjislacionin e brendshëm dhe drejtpërdrejtë zbatohen kur marrëdhëniet i rregullojnë ndryshe nga legjislacioni i brendshëm i Malit të Zi. Mali i Zi në këtë mënyrë është obliguar se legjislacionin e vetë do t' a harmonizojë me parimet e BE-së dhe se do t' a filloj procesin e decentralizimit dhe demokratizimit thelbësor të vetëqeverisjeve lokale. Në preambulë të Kartës Evropiane të vetëqeverisjes lokale theksohet se *“e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisjen e punëve publike është parimi demokratik që vlen në të gjitha vendet – anëtarët e Evropës – dhe se realizimi më i drejtpërdrejtë i kësaj të drejte është i mundshëm pikërisht në nivelin lokal”*.

*Kushtetuta e Malit të Zi*², në kuptimin më të gjerë e rregullon të drejtën e vetëqeverisjes lokale. Me nenin 22 është garantuar e drejta e vetëqeverisjes lokale, ndërsa me nenin 113 është paraparë që në vetëqeverisjen lokale vendoset drejtpërdrejt dhe përmes të përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë, si dhe se *„e drejta e vetëqeverisjes lokale përfshin të drejtën e qytetarëve dhe të organeve të vetëqeverisjes lokale që t' i rregullojnë dhe t' i qeverisin punët e caktuara publike dhe punët tjera, në bazë të përgjegjësisë së vetë dhe në interes të popullsisë lokale”*. Poashtu, Kushtetuta garanton të drejtën e qytetarëve që të janë të informuar çfarë është parakushti kryesor për çdo pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Me nenin 51 u rregullua që *„çdokush e gëzon të drejtën e qasjes në informacione që i ka organi ose organizata shtetërore që i zbatojnë autorizimet publike“*, dhe kjo e drejtë nuk zbatohet vetëm në raste kur ndalja nga shpallja e informacionit të tillë është në interesin e mbrojtjes së jetës, shëndetit publik, moralit dhe jetës private, udhëheqjes së procedurës penale, sigurimit dhe mbrojtjes së Malit të Zi, si dhe zbatimit të politikave të jashtme, monetare dhe ekonomike.

E drejta e pjesëmarrjes së qytetarëve në realizimin e vetëqeverisjes lokale më hollësishtë është rregulluar me akte vijuese ligjore.

*Ligji mbi vetëqeverisjen lokale*³ parasheh, para se gjithash, mënyrat e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje mbi nevojat dhe interesat e tyre: drejtpërdrejtë dhe përmes përfaqësuesve në organet e vetëqeverisjes lokale të zgjedhur në mënyrë të lirë. Neni 99 i këtij ligji parasheh obligimin e komunave për krijimin e kushteve, nxitjen dhe ndihmën e pjesëmarrjes së popullsisë lokale në realizimin e vetëqeverisjes lokale përmes formave të ndryshme të pjesëmarrjes së popullsisë në deklarinim dhe vendimmarrjen mbi punët nga interesi i përbashkët.

Me të njëjtin nen u definua e drejta e popullsisë lokale që për qëllime të plotësimit të nevojave kulturore, sportive, arsimore, shëndetësore, informative dhe nevojave të tjera të marrin pjesë në organe të qeverisjes së shërbimeve publike dhe personave tjera juridike që i kryejnë autorizimet publike dhe i ofrojnë shërbimet qytetarëve, në mënyrë të caktuar me ligje dhe rregulla të posaçme.

Kur bëhet fjala mbi format e pjesëmarrjes së qytetarëve, Ligji mbi vetëqeverisjen lokale parimisht definon format e pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve publike dhe lënë hapësirë komunave që me statute dhe me vendimin mbi pjesëmarrjen e popullsisë lokale, në pajtim me ligjin, më hollësisht t' a rregullojnë mënyrën dhe procedurën e pjesëmarrjes së popullsisë lokale në deklarinim dhe vendimmarrjen mbi punët nga interesi i përbashkët. Në pajtim me nenin 100 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë e qytetarëve në deklarinim

2 *Kushtetuta e Malit të Zi* (“*Fl.zyrtare e Malit të Zi*”, nr. 01/07 nga data 25.10.2007)

3 *Ligji mbi vetëqeverisjen lokale* (“*Fl.zyrtare e RMZ*”, br. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06, “*Fl.zyrtare e Malit të Zi*”, nr. 88/09, 03/10 dhe 38/12)

dhe vendimmarrje janë: iniciativa, iniciativa qytetare, bashkimi qytetarësh, referendumi (vendor dhe komunal) dhe format tjera të deklarimit dhe vendimmarrjes të përcaktuar me statutin. Përveç formave të vendimmarrjes dhe deklarimit të drejtpërdrejtë, qytetarët mund të marrin pjesë në realizimin e vetëqeverisjes lokale dhe përmes peticioneve, propozimeve dhe ankesave, në pajtim me statutin e komunës.

Me nenin 108 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale parashikua obligimi që kuvendi i komunës me një vendim të posaçëm t' a rregulloj mënyrën dhe procedurën e pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve publike me qëllim të pjesëmarrjes së popullsisë lokale në vendimmarrje nga interesi i drejtpërdrejtë dhe i përbashkët.

Me vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni rregullohen: format, mekanizmat (anketimi, lanet e mediave, tabelat e informimit, kutitë për ankesa, propozime dhe sugjerime, ueb, faqet, telefoni i shërbimeve, organizimi i punëtorive nëpër bashkësi lokale, qendrat informuese, vizitat e ligjëruesve, konferencat dhe tryezat rrumbullake profesionale, etj.), subjektet, procedurat, afatet dhe mënyrat e pjesëmarrjes së popullsisë lokale në kryerjen e punëve publike, raporti mbi efikasitetin e procedurave dhe çështjet tjera më rëndësi për aktivitetet e popullsisë lokale në procesin e vendimmarrjes.

*Ligji mbi qasjen e lirë në informacione*⁴ rregullon mënyrën dhe procedurën e realizimit të së drejtës mbi qasjen e lirë në informacione që i kanë organet e pushtetit. Qasja e lirë në informacione paraqet parakushtin kryesor të aktivizimit qytetar dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve dhe vendimmarrjen në vetëqeverisjen lokale. Me shpalljen e informacioneve qytetarët kanë mundësi që të njoftohen me përmbajtjen e tyre dhe t' a përcjellin ligjshmërinë dhe transparencën e punës së mbartësve të autorizimeve publike. Me qasje në informacione nxitet efikasiteti, përfitimi, përgjegjësia dhe afirmohet integriteti dhe legjitimiteti i organeve të pushtetit. Ligji parasheh lirinë e kërkimit të informacioneve nga personat fizik dhe juridik të brendshëm dhe të jashtëm si dhe obligimin e organeve të pushtetit t' i ofrojnë informacionet, si dhe përjashtimet nga ky obligim, kur mbrohen interesat e paraparë me këtë ligj. Poashtu, me këtë ligj rregullohet dhe procedura e realizimit të kësaj të drejte para organeve kompetent.

Të drejtën mbi qasjen në informacione në posedim të organeve të pushtetit e gëzon çdo person fizik dhe juridik nga vendi dhe jashtë, pa detyrë që të ofroj shkaqet dhe t' a shpjegoj interesin e kërkimit të informacionit. Qasje në informacione përfshin të drejtën e kërkimit dhe të pranimit të informacionit, pa marr para sysh qëllimin dhe të dhënat e përmbajtura në ato. Informacioni është një dokument ose pjesë e dokumentit ë formë të shkruar, të shtypur, video, audio, elektronike ose në ndonjë formë tjetër, duke përfshirë dhe kopjet e tyre, pa marr para sysh përmbajtjen e tyre, burimin (autorin), kohën e krijimit ose sistemin e klasifikimit.

Organi i pushtetit është organi i administratës shtetërore (ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor, administrativ), organi i vetëqeverisjes lokale, organi i qeverisjes lokale, institucioni, shoqëri tregtare ose ndonjë person tjetër juridik i të cilit themeluesi, bashkëthemeluesi ose pronari kryesor është shteti ose vetëqeverisja lokale, personi juridik i të cilit puna kryesisht financohet nga të ardhurat publike, si dhe personi fizik, ndërmarrësi ose personi juridik që kryen autorizimin publik ose menaxhon me fondin publik. Informacioni në posedim të organit të pushtetit është posedimi faktik i informacionit të kërkuar nga organi i pushtetit (informacioni i vetë, informacioni i dorëzuar nga organi tjetër i pushtetit ose nga personi i tretë), pa marr para sysh bazën dhe mënyrën e fitimit të tij.

4 Ligji mbi qasjen e lirë në informacione ("Fl.zyrtare e Malit të Zi, numër 44/2012" nga data 09.08.2012)

Ky ligj e siguron një qasje proaktive në informacione me atë që shprehimisht janë të specifikuara informacionet që organi i pushtetit është i detyruar t' i shpallin në internet prezantimin e vetë: udhërrëfyesi për qasje në informacione; regjistrat publik dhe evidencat publike; programet dhe planet e punës; raportet dhe dokumentet tjera mbi punën dhe gjendjen në fushat na kompetenca e organit; projektet, propozimet dhe tekstet përfundimtare të dokumenteve strategjike dhe planeve dhe programeve për zbatimin e tyre; projektet dhe propozimet e ligjeve, si dhe mendimet e eksperteve mbi këto ligje; aktet e veçanta dhe kontratat mbi përdorimin e mjeteve financiare nga të ardhurat publike dhe pronën shtetërore; listat e nëpunësve dhe punëtorëve në administratë shtetërore, me titujt e tyre zyrtare dhe profesionale; listat e zyrtarëve dhe listat e llogaritjes së pagave të tyre dhe të ardhurave të tjera dhe shpërblimeve të lidhura me kryerjen e funksionit publik; vendimeve dhe akteve të veçanta të tjera që janë të rëndësishme për të drejtat, obligimet dhe interesat e personave të tjera, si dhe informacionin që i është lejuar qasja sipas kërkesës.

Procedura e realizimit të së drejtës në qasje të lirë në informacion iniciohet me kërkesë me shkrim ose gojore të personit që kërkon qasjen në informacion. Me nenin 19 të Ligjit mbi qasje të lirë në informacione parashihet përmbajtja e kërkesës për qasjen në informacion:

- 1) emri i informacionit ose të dhënat në bazë të cilëve ai mund të identifikohet;
- 2) mënyra në të cilën dëshirohet të realizohet qasja në informacion;
- 3) të dhënat mbi parashtruesin e kërkesës (emri, mbiemri dhe adresa e personit fizik, ose emri dhe adresa e personit juridik), respektivisht përfaqësuesit të tij ose personit të autorizuar.

Kërkesa mund t' i përmbajnë edhe të dhënat tjera për të cilat parashtruesi mendon se janë të rëndësishme për realizimin e qasjes në informacion. Organi i pushtetit mund t' a parashikoj formularin e kërkesës për qasje në informacion, por është i detyruar që të veproj edhe sipas kërkesës që nuk është parashtruar në formularin e tillë.

Parashtruesi i kërkesës duhet t' a dinë saktësisht se i cili organi e posedon informacionin e kërkuar, përkundrazi kërkesa mund të refuzohet për shkak të jokompetencës. Në rast se kërkesa është e paplotë ose e pakuptueshme, organi i pushtetit e thërret parashtruesin e kërkesës t' i largojnë mungesat në afat prej 8 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës dhe jep udhëzimin mbi mënyrën e largimit të mungesave. Organi i pushtetit do me përfundim do t' i refuzoj kërkesat për qasje në informacion në rast se parashtruesi i kërkesës në kohë të caktuar nuk i korrigjon mungesat. Nëse qasja në informacion kërkon ose nënkupton hartimin e informacionit të ri ose në rast se parashtruesit ishte e lejuar qasja në informacion në afat prej gjashtë muajve të mëparshëm, si dhe në raste kur ekzistojnë shkaqet e parashikuara me këtë ligj për kufizimin e qasjes në informacion të kërkuar, organi i pushtetit e refuzon kërkesën. Në rast se organi i pushtetit nuk është në posedim të informacionit të kërkuar është i obliguar që pa vonesë, nëse e din se i cili organ është kompetent për veprim sipas kërkesës për qasje në informacion, t' a drejtoj kërkesën organit kompetent të pushtetit dhe që mbi këtë fakt t' a lajmëroj parashtruesin e kërkesës.

Organi i pushtetit vendos mbi kërkesën për qasjen e lirë në informacione me vendime me të cilat lejon qasjen në informacionin e kërkuar ose pjesën e tij ose e refuzon kërkesën. Në rast të parashtrimit të kërkesës së rregullt, organi të cilit iu parashtrua kërkesa është i detyruar që në afat brenda 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës t' a marrin vendimin mbi qasjen me të cilin parashtruesi lajmërohet a e posedon organi informacionin e kërkuar dhe a i lejohet qasja në informacion në fjalë. Ky afat mund të zgjatet nëse kërkohet qasja në informacion jashtëzakonisht të gjerë, nëse kërkohet qasja në informacion që përmban të dhënat të mbuluara me ndonjë shkallë të sekretit zyrtar ose në rast se nevojitet kërkimi i shumë informacioneve për t' a siguruar informacionin e

kërkuar, çfarë vështirëson në mënyrë të konsiderueshme punën e rregullt të organit të pushtetit. Organi i pushtetit është i detyruar t' a zbatoj vendimin me të cilin lejohet qasja në informacion në afat prej tri ditëve të punës nga dita e dorëzimit të kërkesës parashtruesit, respektivisht në afat prej pesë ditëve nga dita kur parashtruesi ka dorëzuar provën mbi pagesën e shpenzimeve të procedurës nëse ato shpenzime janë të caktuara në vendim. Në rast të parashtrimin të kërkesës për qasje në informacion për mbrojtje të jetës ose të lirisë së personit, organi i pushtetit është i detyruar q vendimin mbi kërkesë t' a marrin dhe t' a dorëzoj parashtruesit të kërkesës brenda afati prej 48 orëve nga ora e parashtrimin të kërkesës.

Parashtruesi i kërkesës për qasje në informacion dhe çdo person tjetër i interesuar e gëzon të drejtën e mbrojtjes juridike që e realizon në procedurë sipas ankesës dhe me kontest administrativ.

Ligji mbi referendum⁵ parasheh referendumin si një formë të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në Mal të Zi. Me ligj janë definuar kushtet dhe procedurat e shpalljes së referendumit në nivelet kombëtar dhe lokal. Për deklarin e qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga kompetenca e komunës mund të shpallet referendumi për territorin e komunës (referendumi komunal). Në pajtim me dispozitat e nenit 3 të këtij ligji, referendumi komunal duhet të shpallet për shkak të deklarin të qytetarëve mbi formimin e komunave të reja, ndërprerjes ose bashkimit të komunave ekzistuese dhe ndryshimit të selive të komunave. Referendumi komunal mund të shpallet për shkak të deklarin paraprak të qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga kompetencat e kuvendit të komunës në raste, në mënyrë dhe sipas procedurës së përcaktuar me statutin e komunës, në pajtim me ligj.

Kuvendi i komunës merr vendimin mbi shpalljen e referendumin, në pajtim me statutin e komunës. Me këtë vendim përcaktohet posaçërisht: teksti i pyetjes mbi të cilën qytetarët do të deklarohen në referendum dhe data e mbajtjes së referendumin. Me ligj është parashikuar se komunat me akte të veta (me Vendim), që është në pajtim me Statutin e Komunës, mund t' i rregullojnë deri në detaje çështjet e shumta të lidhura me këtë formë të deklarin të qytetarëve.

Statutet e njësive të vetëqeverisjeve lokale në detaje e rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në nivelin lokal duke rregulluar drejtpërdrejtë pjesëmarrjen në procese të vendimmarrjes mbi punët lokale nga interesi i drejtpërdrejtë dhe i përbashkët.

Qytetarët drejtpërdrejtë marrin pjesë në deklarin dhe vendimmarrjen përmes: iniciativës, iniciativës qytetare, bashkimit të qytetarëve, referendumin, peticionit, propozimeve dhe ankesave qytetare. Poashtu, me statute mund të parashihen edhe format tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve, në pajtim me kërkesa dhe nevoja të komunës.

Vendimi mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në kryerjen e punëve publike rregullon mënyrën dhe procedurat e pjesëmarrjes së popullsisë lokale në kryerjen e punëve publike, format dhe mekanizmat e pjesëmarrjes, subjektet e pjesëmarrjes, masat dhe aktivitetet që i ndërmarrin organet e komunës për shkak të nxitjes dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset e planifikimit, vendimmarrjes dhe implementimit. Ky vendim ka rëndësinë e madhe në realizimin e principit të pjesëmarrjes së qytetarëve në realizimin e vetëqeverisjes lokale, kontribuon punës transparente të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe siguron marrëdhëniet dhe bashkëpunimin mes organeve të vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve. Me vendim deri në detaje e rregullohen pjesëmarrja e qytetarëve, në pajtim me Statutin dhe Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale. Me vendim janë të definuar mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në

⁵ *Ligji mbi referendum* ("Fl. zyrtare e RMZ", nr. 9/01)

kryerjen e punëve publike – iniciativa, iniciativa qytetare, bashkimet qytetarësh, referendumi (vendor dhe komunal), ankesa qytetare dhe peticioni, si dhe format tjera të deklarimit dhe të vendimmarrjes të përcaktuar me Statut. Me vendim rregullohet edhe procedura e diskutimit publik – organet e komunës janë të detyruar që përmes organizimit të diskutimeve publike dhe profesionale t’u sigurojnë qytetarëve mundësinë për të japin me shkrim dhe në mënyrë gojore propozimet, vërejtjet, sugjerimet dhe mendimet mbi akte që janë lëndë e diskutimit.

2.1.1. FORMAT E PJESËMARRJES SË DREJTPËRDREJTË NË PUNËN E VETËQEVERISJEVE LOKALE

Nën forma të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë/indirekte nënkuptohen: iniciativa, iniciativa qytetare, bashkimet qytetarësh, referendumi. Siç kemi përmendur më parë, këto forma janë rregulluar më preciz me statute të njëjste të vetëqeverisjes lokale dhe me Vendim mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në kryerjen e punëve publike

2.1.2. INICIATIVA

Iniciativa është akti me të cilin qytetarët e nisin pranë organeve të vetëqeverisjes lokale zgjidhjen e çështjeve të caktuara për të cilat janë të interesuar. Qytetarët e kanë të drejtën e nisjes së iniciativës për shqyrtimin dhe vendosjen mbi çështjet e caktuara të cilat janë nga interesi për popullsinë lokale. Çështjet për të cilat qytetarët kanë të drejtë t’ a nisin iniciativën janë këto:

- përcaktimi i linjave në transportin publik brenda dhe jashtë qytetit;
- ndërtimi, zgjerimi dhe rregullimi i varrezave
- asfaltimi i rrugëve
- ofrimi i shërbimeve komunale
- zhvillimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor
- informimit më të mirë
- përcaktimit të orarit të punës në objekte hoteliere
- mbrojtja e monumenteve
- zhvillimi i sportit
- zhvillimi i kulturës dhe i artit
- mbrojtja nga zhurma
- ndërtimi i objekteve infrastrukturore
- dhe çështjeve të tjera për të cilat mund të parashtrahet ankesa qytetare dhe peticioni

Iniciativën mund t’ a nisin një qytetar – individ. Shërbimet komunale (sekretariatet) janë të detyruar që të marrin vendim mbi iniciativën dhe mbi këtë t’ a lajmërojnë parashtruesin në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të iniciativës. Në rast se organi kompetent nuk vepron sipas iniciativës, parashtruesi i iniciativës mund të drejtohet kryetarit të Komunës apo Kuvendit.

2.1.3. INICIATIVA QYTETARE

Me iniciativë qytetare, si formë të pjesëmarrjes së qytetarëve në punë të vetëqeverisjeve lokale, propozohet miratimi ose ndryshimi i aktit me të cilin rregullohen çështjet e rëndësishme nga kompetencat e vetëqeverisjes lokale.

Çështjet mbi të cilat mund të nisët iniciativa qytetare përcaktohen me Statutin e njësisë së vetëqeverisjes lokale. Qytetarët kanë të drejtë t' a nisin iniciativën qytetare për shkak të:

- përcaktimit të tatimeve
- planifikimit dhe rregullimit hapësinor
- rregullimit dhe përdorimit të truallit ndërtimor
- transportit publik të udhëtarëve brenda dhe jashtë qytetit
- mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve
- vendosjes së objekteve të përkohshme
- çështjeve të tjera që janë në kompetenca të komunës

Numri i nënshkrimeve i nevojitur për nisjen e iniciativës qytetare është i definuar me Statutin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ose me Vendim mbi pjesëmarrjen e popullsisë në kryerjen e punëve publike. Organi kompetent për vendosje mbi iniciativën qytetare është kuvendi komunal. Qytetarët që e nisin iniciativën qytetare duhet t' a kanë vendbanimin në territorin e komunës në të cilën nisët iniciativa. Numri i nënshkruesve dhe saktësia e të dhënave kontrollohet nga shërbimet për punët administrative, ndërsa përmbajtja e saj vlerësohet nga trupi punues i kuvendi komunal kompetent për çështjet që janë lëndë e iniciativës. Nëse iniciativa qytetare është e parregullt, ajo i kthehet parashtruesit për t' u plotësuar, dhe ai është i detyruar t' a plotësoj brenda afatit prej 30 ditëve. Kuvendi do t' a refuzoj iniciativën qytetare në rast se parashtruesi i iniciativës qytetare brenda këtij afati nuk i largon mungesat e përcaktuara.

Afati brenda të cilit Kuvendi është i detyruar që të deklarohet mbi iniciativën e parashtruar është 60 ditë.

Në seancën gjatë të cilës shqyrtohet iniciativa qytetare, kuvendi është i obliguar t' i caktoj detyrat organeve kompetente. Nëse kuvendi e pranon iniciativën qytetare mbi çështjen mbi të cilën është nisur iniciativa qytetare, mund të shpallet referendumi në afat brenda 90 ditëve nga dita e vendosjes mbi iniciativën.

2.1.4. BASHKIME QYTETARËSH

Një nga format kryesore të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve është dhe bashkimi qytetarësh. Me Ligj mbi vetëqeverisje lokale (neni 103) u parashikua se bashkimi qytetarësh, me shumicën e votave të qytetarëve të pranishëm, miraton kërkesat dhe propozimet dhe i dërgon organit kompetent.

Bashkimi qytetarësh thirret nga organi kompetent i bashkësisë lokale sipas iniciativës së vetë ose me propozim të numrit të caktuar të qytetarëve. Numri i qytetarëve shkon prej 1% deri në 2% të qytetarëve, nga rajoni për të cilin organizohet bashkimi. Poashtu, edhe kryetari i kuvendit dhe kryetari i komunës mund t' a thërrasin bashkimin, për shkak të fitimit të mendimit të qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga interesi lokal dhe këshilltari në kuvendin komunal që është regjistruar

në listën votuese të zonës për të cilën organizohet bashkimi, për shkak të fitimit të mendimit mbi ndonjë çështje e caktuar nga vetë qytetarët. Thirrja e bashkimit bëhet me thirrje publike, së paku 7 ditë para mbajtjes së bashkimit. Thirrja shpallet në të gjitha mjetet e informimit dhe vendoset në tabelën e bashkësisë lokale dhe kuvendit komunal, por mund të shpallet dhe në objekte publike, vendet tjera për shpallje, hyrje të godinave dhe në do mënyrë tjetër të përshtatshme.

Kërkesa për thirrjen e bashkimit qytetarësh duhet të përmbajnë në formë të shkruar arsyetimin e çështjes së propozuar që bashkimi duhet ta shqyrtoj. Nëse kërkesën për thirrje të bashkimi e parashtrajnë qytetarët, atëherë kërkesa duhet të përmbajnë emrin dhe mbiemrin e çdo qytetarit, adresën, nënshkrimin me dorë të vetë dhe numrin e veçantë të amzës. Çështja e numrit të qytetarëve që nevojiten për punën e bashkimit është rregulluar nga komuna në komunë (nga 3% deri në 5% të qytetarëve të zonës për të cilën thirret bashkimi). Qytetarët në bashkim:

- japin propozime organeve komunal në lidhje me përgatitjen e programeve dhe planeve të zhvillimit të komunës
- japin propozime në lidhje me mbrojtjen e hapësirës nga ndërtimi pa leje
- japin propozime në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit jetësor
- nisin iniciativat dhe propozimet për themelimin e bashkësive lokale të reja dhe ndryshimin e kufijve të bashkësive lokale
- marrin vendimin mbi themelimin e bashkësisë lokale
- shqyrtojnë çështjet tjera me rëndësi për popullsinë lokale, në pajtim me ligjin, statutin dhe vendimin e kuvendit

Bashkimi qytetarësh vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

2.1.5. REFERENDUMI

Një nga mekanizmat më të rëndësishëm të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal është referendumi. Për shkak të deklaramit të qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga kompetencat e komunës mund të shpallet referendumi për territorin e komunës (referendumi komunal) ose për një pjesë të territorit të komunës (referendumi vendor). Referendumi si formë e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në punën e vetëqeverisjes lokale në Mal të Zi është rregulluar me Ligjin mbi referendum (i botuar në Fletën zyrtare nr. 9/01) me atë që njësitë e vetëqeverisjes lokale me akt të vetë (Vendim), që është në pajtim me statutin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, kanë mundësi që deri në detaje t' i rregullojnë çështjet e shumta të lidhura me këtë formë të deklaramit të qytetarëve. Sipas Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, referendumi komunal duhet të shpallet për shkak të deklaramit paraprak të qytetarëve mbi themelimin e komunave të reja, ndërprerjes ose bashkimit të komunave dhe ndryshimit të selisë së komunës, dhe mund të shpallet për shkak të deklaramit paraprak të qytetarëve mbi çështjet e caktuara nga kompetenca e komunës, në raste, mënyrë dhe sipas procedurës së përcaktuar me statutin, në pajtim me ligjin.

Vendimin mbi shpalljen e referendumit komunal e merr kuvendi i komunës, në pajtim me statut. Vendimi duhet t' i plotësoj dy kriteret formale:

1. formulimi i qartë i pyetjes mbi të cilën qytetarët do të deklarohen në referendum, dhe
2. data e mbajtjes së referendumit.

Referendumin komunal e zbaton komisioni për zbatimin e referendumit komunal dhe këshillat votues. Komisioni për zbatim të referendumit komunal emërohet nga kuvendi i komunës më së largëti në afat prej 10 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit mbi shpalljen e referendumit. Qytetari që ka të drejtë të votimit në referendum mund t' a paraqes ankesën komisionit kompetent për shkak të parregullsive në procesin e zbatimit të referendumit.

Në referendumin vendor qytetarët e një pjese të territorit të komunës deklarohen mbi çështjet nga kompetencat e vetëqeverisjes lokale. Çështjet mbi të cilat qytetarët do të deklarohen përmes referendumit vendor, si dhe procedura e shpalljes dhe e zbatimit të referendumit përcaktohen me Ligjin mbi referendum, respektivisht me Statutin.

2.1.6. FORMAT TJERA TË PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PUNËN E VETËQEVERISJEVE LOKALE

Përpos formave të vendosjes dhe deklarimit të drejtpërdrejtë, qytetarët mund të marrin pjesë edhe në realizimin e vetëqeverisjes lokale dhe përmes peticioneve, propozimeve dhe ankesave, në pajtim me statut të komunës.

Këto forma të deklarimit të qytetarëve janë të rregulluara me Ligj mbi vetëqeverisjes lokale (nenet 106 dhe 107). Çdokush ka të drejtë të paraqesin ankesën qytetare ose t' a dërgojnë petitionin ose propozimin organeve të vetëqeverisjes lokale, si dhe që nga organet të kërkoj informacionet nga fushëveprimi i punës së tyre.

Peticioni është akti kolektiv i “protestës” me të cilin qytetarët protestojnë dhe kërkojnë nga organi kompetent që të ndërmarrin masat e nevojshme me qëllim të zgjidhjes së problemit të caktuar. Peticionin e parashtron – nënshkruan grupi i qytetarëve. Procedura e parashtrimit të petitionit është i rregulluar me statutin e komunës. Organi është i detyruar që brenda afatit prej 30 ditëve të marrin vendimin dhe të japin përgjigjën parashtruesve të petitionit.

Ankesa është akti individual ose kolektiv me të cilin qytetari ose grupi i qytetarëve ankohet për ofrimin joefikas ose jociësor të shërbimeve publike. Çdokush a të drejtë të paraqesin ankesën. Procedura e paraqitjes së ankesës rregullohet me statut. Organi të cilit iu drejtua ankesa është i detyruar që brenda afatit prej 30 ditëve të japin përgjigjën ankuesit ose të marrin një vendim të duhur.

Procedura e paraqitjes dhe veprimi i organeve sipas ankesës qytetare dhe petitionit më hollësisht rregullohen me statutin e komunës. Organet të cilëve iu drejtuan kërkesat në fjalë janë të detyruar të marrin vendim, respektivisht të japin përgjigje brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës.

2.1.7. STANDARDET E VEPRIMIT TË VETËQEVERISJES LOKALE DREJT QYTETARËVE

Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ka definuar standardet e veprimit të vetëqeverisjes lokale ndaj qytetarëve. Në raport me qytetarët, organet e vetëqeverisjes lokale janë të detyruar të sigurojnë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të popullsisë lokale në mënyrë ligjore dhe efikase, me respektimin e personalitetit dhe dinjitetit të qytetarëve.

Funksionarët dhe zyrtarët lokal, në raport me qytetarët, janë të detyruar t'i përmbahen kodit të etikës të përcaktuar për zyrtarët dhe funksionarët publik. Gjithashtu janë të detyruar që në realizimin e interesave të qytetarëve të ju ofrojnë informacionet, shpjegimet dhe lajmërimet e domosdoshme. Dhënia e lajmërimeve bëhet nëpërmjet mjeteve teknike, broshurave dhe mjeteve të informimit publik. Në veprimin në çështjet administrative, organet e vetëqeverisjes lokale janë të detyruar që në mënyrë publike të theksojnë standardet e veprimit. Funksionarët lokal dhe udhëheqësit e organeve të administratës janë të detyruar që caktojnë edhe kohën për pranimin e qytetarëve.

Në objektet publike, ku janë të vendosur organet e vetëqeverisjes lokale dhe shërbimet publike, duhet të jetë i cekur emri i organit, respektivisht i shërbimit publik. Në një vend të dukshëm brenda organit apo shërbimit publik duhet të jetë e cekur renditja e dhomave. Në hyrje të dhomave zyrtare duhet të jetë i cekur emri personal dhe funksioni apo profesioni i zyrtarit. Personat e punësuar, gjatë shërbimit, janë të detyruar të mbajnë shenjat e dukshme me emrin e tyre personal, imazhin dhe profesionin, në pajtim me rregullin që e sjell ministria përgjegjëse për çështjet e vetëqeverisjes lokale. Organet e vetëqeverisjes lokale janë të detyruar të sigurojnë librin e përshtypjeve dhe kutinë për vërejtje, sugjerime dhe ankesa. Gjithashtu janë të detyruar që qytetarëve t'u sigurojnë pranimin nga udhëheqësi i organit, për nënshkrimin e vërejtjes apo ankesës për punën e organit apo raportin e parregullt të zyrtarëve.

Organi është i detyruar që të sjellë përgjigje në formë të shkruar për ankesat e qytetarëve, brenda afatit prej 15 ditëve, në rast kur qytetari e kërkon këtë.

2.1.8. FORMAT E BASHKËPUNIMIT DHE STRUKTURAT E BASHKËPUNIMIT MES VETËQEVERISJEVE LOKALE DHE ORGANIZATAVE JOQEVERITARE NË MAL TË ZI

Bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale me organizatat joqeveritare ka një rol të madh për ngritjen e vetëdijes mbi aktivizmin e qytetarëve, si dhe për përforcimin e kulturës politike pjesëmarrëse. Organizatat joqeveritare kanë rëndësi të madhe për zhvillimin gjithëpërfshirës të shoqërisë, veçanërisht për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në jetën publike lokale dhe në procesin e vendimmarrjes. Rëndësia më e madhe e tyre pasqyrohet në njohjen e nevojave dhe interesave të qytetarëve, në artikullimin e atyre nevojave dhe interesave, dhe pastaj në përfaqësimin publik nëpërmjet aktiviteteve të tyre të rregullta. Prandaj, vetëqeverisja lokale duhet të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme që sa më shumë të mbështesë punën e organizatave joqeveritare brenda komuniteteve të veta.

Format e bashkëpunimit të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave joqeveritare në Mal të Zi është e përcaktuar me neni 116 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale. Ky bashkëpunim realizohet përmes:

- 1) informimit për të gjitha çështjet me rëndësi për sektorin joqeveritar;
- 2) konsultimit me sektorin joqeveritar për programet e zhvillimit të vetëqeverisjes lokale dhe projekt akteve të përgjithshme që i miraton kuvendi;
- 3) mundësimin të pjesëmarrjes në punën e grupeve të punës për përgatitjen e akteve ligjore apo për hartimin e projekteve dhe programeve;
- 4) organizimit të diskutimeve të përbashkët publike, tryezave të rrumbullakëta, seminareve etj.;
- 5) financimit të projekteve të organizatave joqeveritare me interes për banorët lokal, sipas kushteve të caktuara me aktin përgjithshëm të kuvendit;

- 6) sigurimit të kushteve për punën e organizatave joqeveritare, në pajtim me mundësitë e qeverisjes lokale;
- 7) mënyrave të tjera të caktuara me statutin e kuvendit.

Me qëllim të realizimit të avancimit të punës së vetëqeverisjes lokale Ligji mbi vetëqeverisjen lokale parashikon themelimin e Këshillit për zhvillimin dhe mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale. Anëtarët e Këshillit i zgjedhë kuvendi nga rëndi i qytetarëve të dalluar dhe me autoritet, organizatave joqeveritare dhe ekspertëve me rëndësi për vetëqeverisjen lokale. Këshilli ka të drejtë që të ju nënshtrojë propozime për avancimin dhe zhvillimin e vetëqeverisjes lokale, rritjen e nivelit të cilësisë shërbimeve publike, mbrojtjen e të drejtave dhe obligimeve të bashkisë të siguruara me Kushtetutë dhe ligj dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të banorëve lokal. Më statutin e komunës dhe aktin mbi themelin e Këshillit më afër përcaktohen të drejtat dhe detyrat, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes dhe e punës së Këshillit si dhe çështjet tjera të rëndësishme për funksionimin e tij. Në përbërje të këtij trupi zgjedhën edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

Duhet theksuar ekzistimin e institutit „karrige e zbrazët”. Me themelimin e këtij instituti u mundësua pjesëmarrja e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare në punën e kuvendeve lokale pa drejtë të vendimmarrjes. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare mund të marrin pjesë në seanca të kuvendit në mënyrë dhe sipas procedurave të parashikuara me rregulloret e punës së kuvendeve. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare marrin pjesë sipas thirrjes në seanca të Kuvendit dhe kanë të drejtë të paraqesin propozimet ose mendimet e veta mbi çështjet që ishin në rendin e ditës por pa drejtë të votimit, me atë që ekspozimi mund të zgjas më së shumti pesë minuta.

2.2. KORNIZA NORMATIVE E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES NË NIVELIN LOKAL NË SHQIPËRI

Pjesëmarrja e publikut është një element kyç për demokracinë e një vendi. Shqipëria I është nënshtruar ndryshimeve të mëdha në lidhje me përfshirjen e qytetarëve në hartimin, formulimin dhe në vendimmarrjen –te proceseve në lidhje me ligjin dhe formësimin e sistemit të tij demokratik. Megjithatë, një sfidë vazhdon të jete informacioni I paket dhe kuptimi nga qytetarët në lidhje me të drejtat dhe përgjegjshmerite e tyre si qytetare dhe pjesëmarrje të dobët të individëve të përfshirë në hartimin, formulimin dhe monitorimin të ligjeve dhe në procesin e vendimmarrjes dhe zbatimi I strukturës të përshtatshme ligjore nga zyrtarët publik dhe nga qeveria lokale.

E drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse dhe instrumente të tjerë të politikave publike nuk është një e drejtë që nuk specifikohet saktësisht dhe shprehimisht nga Kushtetuta e Shqipërisë. Kjo e drejtë derivon nga një sërë parimesh të sistemit politik demokratik, të cilat garantojnë nga Kushtetuta si e drejta e lirisë së aksesit në informacionin publik apo me rëndësi për publikun, e drejta e peticioneve ndaj autoriteteve, e drejta e një ambienti të shëndetshëm, e drejta për të propozuar ligje, e drejta e referendumit, e drejta e lirisë së fjalës dhe grumbullimit dhe organizimit etj. Ushtrimi i këtyre të drejtave rregullohet me ligje dhe akte normative të tjera në mënyrë të detajuar.

Baza ligjore kryesore për Pushtetin Vendor në Shqipëri i ka tre shtyllat kryesore mbështetëse ne:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998
2. Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore, ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me date 21 tetor 1998.
3. Ligji Nr.8652, datë 31.07.2000: *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”*, *I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9208, datë 18.03.2004: “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000; “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” dhe Ligji nr. 8653 dt. 31.07.2000 “ Për ndarjen administrativo-territoriale e njësive te qeverisjes vendore ne RSH”.*

Më poshtë janë listuar disa, por jo të gjitha, format e pjesëmarrjes qytetare ne nivel lokal të përdorur në Shqipëri.

- Grupet Këshillimore Qytetare
- Planifikimi Strategjik i Qytetit
- Ndërtimi i Koalicionit
- Organizimi Komunitar
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Dëgjesat publike
- Kartat Raportuese

2.2.1. KUSHTETUTA E SHQIPERISE6

PARIME THEMELORE

Neni 2

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit.
2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.

LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

LIRITË DHE TË DREJTAT POLITIKE

Neni 46

1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.

6 http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1150_1.php

2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj.
3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.

Neni 48

Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

PROCESI LIGJVËNËS

Neni 81

Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

Neni 134

1. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të:
 - a) Presidentit të Republikës;
 - b) Kryeministrit;
 - c) jo më pak se një së pestës së deputetëve;
 - ç) Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - d) çdo gjykate sipas rastit të nenit 145 pika 2 të kësaj Kushtetute;
 - dh) Avokatit të Popullit;
 - e) organeve të qeverisjes vendore;
 - ë) organeve të bashkësive fetare;
 - f) partive politike dhe organizatave të tjera;
 - g) individëve.
2. Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët dh, e, ë, f dhe g të paragrafit 1 të këtij neni mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre.

REFERENDUMI

Neni 150

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.
2. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum.
3. Parimet dhe procedurat për zhvillimin e referendumit, si dhe vlefshmëria e tij parashikohen me ligj.

2.2.2. LIGJE DHE RREGULLORE QE NDIKOJNË TEK E DREJTA E ORGANIZMIT

Ligjet Shqiptare që ndikojnë tek e drejta e organizimit janë në një vije me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut të cilat Shqipëria i ka nënshkruar dhe ratifikuar.

Kushtetuta Shqiptare në mënyrë eksplicite mbron të drejtën e lirisë së organizimit si citohet edhe më sipër.

Ne vitin 2001 Shqipëria miratoi dhe vuri në fuqi një sere ligjesh progresive për rregullimin e regjistrimit dhe ciklit të ekzistencës së Organizatave Jo-Fitimprurëse si forme të organizimit të qytetareve në baze të interesave të tyre, dhe si forma më të larta dhe më të strukturuar pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje dhe qeverisje, si atë qendrore dhe vendore, të gjitha në linjë me normat ndërkombëtare mbi të drejtën e financimit të një personi juridik për kryerjen e aktiviteteve dhe organizimeve.

L I G J

Nr.8788, datë 7.5.2001

PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE ⁷

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut

Qëndrimi i përgjithshëm midis ligjvënësve është se legjislacioni i 2001 mbi Organizatat jo-Fitimprurëse është përmirësuar ndjeshëm nga ai paraardhës. Paketa ligjore legjislative e vitit 2001 ka nevojë për një seri ligjesh dhe aktesh normative vijuese, përfshirë këtu legjislacionin mbi licencimin e OJF;ve dhe taksimin e tyre.

2.2.3. KORNIZA LIGJORE PËR LIRINË E SHPREHJES

Katër elementet që aftësojnë përfshirjen qytetare -- shoqatat, burimet, informacioni dhe negocimi -- varen nga liria e shprehjes. Pa lirinë e shprehjes, njerëzit nuk janë të aftë të formojnë shoqata, nuk mund të mobilizojnë burimet në mënyrë efektive, nuk janë në gjendje të kërkojnë dhënien e informacionit zyrtar, apo debatit me qeverinë dhe institucione të tjera qeveritare.

Kushtetuta e Shqipërisë mbron të drejtën e lirisë së fjalës dhe lirinë e shtypit.⁸

Ajo gjithashtu mbron të drejtat e minoriteteve për t'u "bashkuar në organizata të shoqata për mbrojtjen e interesave dhe identitetit të tyre".

Ligji shqiptar për median elektronike, i cili hyri në fuqi në 1998 dhe është ndryshuar në vitin 2000 dhe 2003, rregullon aktivitetet e medias dhe radiotelevizioneve publike e private. Parimi thelbësor i tij është që Autoriteti i Transmetimit "mbikëqyr në mënyrë të paanshme, të drejtën e informimit, opinionet politike dhe besimet fetare, personalitetin, dinjitetin, privacinë e qenieve njerëzore si edhe liritë e të drejtat e tyre themelore". Ligji gjithashtu garanton pavarësinë editoriale.⁹

Një nga kërkesat më domethënëse të ligjit është krijimi i Këshillit Kombëtar të Radio-Televizionit (KKRT). KKRT ka për detyrë implementimin e ligjeve të medias së vendit, garantimin e konkurrencës të drejtë në tregun e medias elektronike, menaxhimin e spektrit të radio-frekuencave për transmetime televizive dhe radiofonike, lëshimin dhe revokimin e licencave për televizionet e radiot private dhe hartimin e rregulloreve lidhur me licencimin.¹⁰

⁷ <http://www.partnersalbania.org/skedaret/1233137481-NGOalb.pdf>

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu 2, Neni 22

⁹ LIGJI Nr. 8410, dt 30.9.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë"

¹⁰ Televizioni dhe radio publike nuk ka nevojë për licensë.

Si radio e televizioni publik ashtu edhe ato private duhet të transmetojnë lajme të përditshme, dhe emisionet e lajmeve duhet të paraqesin faktet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, dhe “duhet të promovojnë formimin e opinioneve të lira dhe nuk duhet t’i shërbejnë interesave të asnjërës parti politike apo organizate, grupi ekonomik, dhe shoqate apo komunitet fetar në mënyrë të njëanshme”.

Ligjet shqiptare lidhur me shpifjen, parashikojnë sanksione penale dhe, është e drejtë të thuhet se këto ligje frenojnë shprehjen e lirë. Ligjet penale të Shqipërisë përdoren për të ngacmuar mediat dhe aktivistet politikë. Përveç kësaj, një padi e shpifjes civile -- apo edhe kërcënimi për një padi të tillë – dhe mundësia e pësimit të një dëmi të konsiderueshëm material por edhe moral, mund të përdoren (dhe ka raste të tilla) për të bërë presion mbi gazetarët apo persona të tjerë kritike ndaj personave të veshur me autoritet shtetëror. Ligjet dhe rregulloret në lidhje me të drejtën e fjalës dhe të autorit, konkurrencën e lirë dhe reklamën e qeveritare, ndikojnë në përdorimin efektiv të medias nga shoqëria civile.

2.2.4. KORNIZA LIGJORE PËR TE DREJTËN E INFORMIMIT

Shqipëria ofron garanci kushtetuese dhe ligjore të drejtës për informim. Kushtetuta aktuale, e cila hyri në fuqi në Nëntor 1998, e garanton këtë të drejtë në nenin 23 sipërpërmendur.

Neni 23 i Kushtetutës së 1998 citon se:

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Shtate muaj më vonë, u miratua edhe ligji “Për aksesin në Informim, nr 8503 – E drejta e informimit për Dokumentet Zyrtare”, duke qenë kështu i pari vend në rajon që adoptoi legjisllacionin për t’i siguruar qytetarëve të drejtën e informimit.

Neni 23 i Ligjit 8503 thekson se “çdokush ka të drejtën, në përputhje me ligjin, të marrë informacion mbi aktivitetin e organeve shtetërore, si dhe të personave që kanë funksione shtetërore”¹¹

Vetëm duke pasur informacionin e duhur dhe të sakte, qytetarët mund të diskutojnë dhe të kërkojnë llogari mbi aktivitetin e qeverisë së tyre, qendrore apo lokale, dhe shoqëria civile të mund të jete mjaftueshëm e informuar për atë që bëjnë qeveritë dhe zyrtarët e tyre, të monitorojnë dhe vlerësojnë performancën e tyre. Nëse e liria e shprehjes është oksigjeni për angazhimin qytetar, e drejta e aksesit në informacion është një ushqyes thelbësor i këtij angazhimi të suksesshëm.

Ligji shqiptar mbi të drejtën e informimit hyri në fuqi në Qershor 1999. Sipas tij, gjithë personat mund të kërkojnë informacion nga dokumentet zyrtare pa pasur nevojë të shpjegojnë arsyet e nevojës për këtë informacion; dokumentet dhe informacioni mund të mos jepen vetëm në rastet kur një ligj tjetër e pengon këtë; në raste të tilla, autoritetet publike duhet t’i bëjë me dije me shkrim kërkuesit të informacionit arsyet e refuzimit të dhënies së këtij informacioni.

¹¹ <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%208503%20Dat%C3%AB%2030-06-1999.htm>

Çdo organ shtetëror, qendror apo lokal, duhet të vendosë nëse do ta pranojë kërkesën për informacion brenda 15 ditëve kalendarike nga momenti i paraqitjes së kësaj kërkesë, për më shumë, këtyre kërkesave nga momenti i pranimit duhet tu përgjigjen brenda 40 ditëve.¹²

Agjencitë qeveritare duhet t'i japin informacion publikut, falas, mbi mënyrat e kërkimit dhe marrjes së informacionit dhe dokumenteve zyrtare, vendndodhjen, rregullat dhe procedurat për të marrë këtë informacion.

Individët që besojnë se të drejtat e tyre të garantuar me ligj janë shkelur, mund të drejtojnë një ankese në gjykatën administrative apo ligjore dhe nëse shkelja e këtyre të drejtave ka shkaktuar dëm, individë ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim në formë të ndryshme.

Zyra e avokatit të popullit është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve të garantimitit të paprekshmërisë dhe mirëaplikimit të demokracisë tek të gjithë qytetarët.¹³

Gjithashtu, Ligji 8485 (5 dhjetor 1999, "Kodi i Procedurave Administrative") siguron të drejtën e informatave që përmbajnë dokumentet zyrtare, edhe në rastet kur kërkuesi nuk interes legjitim personal në këtë çështje. Për më tepër, Kodi nënvizon një të drejtë informimi që vlen vetëm për pjesëmarrësit në "procedurat administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" dhe vetëm për dokumentet e përdorura në procedurën në fjalë.

Në shtator 2004, grupi I advokimit në Londër për Nenin 19, lëshoi një Memorandum mbi Ligjin Shqiptar, duke bërë disa rekomandime për ndryshimin e Ligjit 8503. Bazuar në këtë, në 2007, Qendra e Zhvillimit dhe Demokratizimit të Institucioneve (CDDI), në bashkëpunim me Iniciativën e Drejtësisë së New York-ut, filloi rishikimin e aspekteve të ndryshme të ligjit (përcaktime, qëllime, kufizime dhe modalitete) për të paraqitur disa amendamente përfundimtare në Parlament. Këto propozime u bënë publike në mars 2007 gjatë takimit të Forumit Civil Shoqëror në Tiranë. Në Korrik 2010 Komisioni Parlamentar në Arsimin dhe Pajisjet për Informimin Publik, diskutoi dhe aprovoi dy projekt-propozime për amendimin e ligjit, por vendimi përfundimtar iu la Asamblesë, e cila, për arsye që nuk dihen, asnjëherë nuk diskutoi apo votoi për këtë gjë.

2.2.5. LIGJET QË NDIKOJNË TEK NEGOCIATAT

Ligji shqiptar parashikon mekanizmat e mëposhtme institucionale përkatëse për "Negocimin", që është vendi dhe rregullat sipas të cilave qytetarët mund të negociojnë dhe debatojnë çështje të shqetësimit publik me zyrtarë të Qeverisë.

- Zyra e Avokatit të Popullit, e themeluar nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe nga një ligj i 1999, është një zyrë avokati e ngarkuar me përgjegjësinë e përgjigjes së kërkesave të individëve, grupeve të individëve apo organizatave joqeveritare që besojnë se të drejtat, liritë apo interesat e tyre të ligjshme janë dhunuar nga veprime qeveritare të paligjshme apo të papërshtatshme apo nga dështimi i një veprimi.
- Rregullat parlamentare i lejojnë publikut dhe medias të marrë pjesë në seancat plenare të Parlamentit, dhe radio e televizioni t'i transmetojnë këto seanca; ligjet parashikojnë gjithashtu për publikun dëgjimin e komisioneve parlamentare, pjesëmarrjen publike në mbledhjet e komisionit dhe aksesin publik në projektligje dhe raporte parlamentare.

¹² Ligji nr 8503, neni 11

¹³ http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=548

- Dhjetë ligjet kryesore në lidhje me decentralizimin, përfshirë edhe *Ligjin mbi Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Lokale (ligji OFQL)*¹⁴, janë në vend ligjet bazë për krijimin e autonomisë lokale dhe decentralizimin e përgjegjësive nga qeverisja qendrore drejt autoriteteve lokale. Kuadri ligjor lidhur me decentralizimin është veçanërisht progresiv në sigurimin e pikave specifike të përfshirjes së komunitetit në procesin vendimmarrës të qeverisë.

¹⁴ http://www.moi.gov.al/drupal1/qeverisja/qeverisja_vendore.pdf

3. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BASHKËPUNIMIT MES ORGANIZATAVE TË SHOQRËRISË CIVILE DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPERI

3.1. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BASHKËPUNIMIT MES ORGANIZATAVE TË SHOQRËRISË CIVILE DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI

Komuna e Budves

TITULLI I PROJEKTIT: „Mblidhe që mos të hidhet“

Partnerët në projekt: OJQ „Iniciativa e pavarur qytetare“, OJQ „Eko forum“, OJQ „Green.me“, SHKIP Budva, Organizata turistike e komunës së Budves, IP „Mediterran reklam“, RTV Budva dhe kompania private Advertising Group

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

OJQ „Iniciativa e pavarur qytetare“ me seli në Budva e ka nisur iniciativën për realizimin e projektit „Mblidhe që mos të hidhet“ në bashkëpunim me Komunën e Budves, më qëllim të grumbullimit të organizuar të mbeturinave të seleksionuara në territorin e komunës.

Komuna e Budves për një periudhë të gjatë ka pas probleme me deponimin e mbeturinave komunale për shkak të mosekzistimit të deponisë sanitare rajonale. Nga viti 2008, kur në komunë ndodhi situata e jashtëzakonshme për shkak të mosekzistimit të vendit për deponimin e mbeturinave komunale, u ndërpre përdorimi i deponisë Llovanja, ndërsa mbeturinat komunale u deponuan në Podgoricë, çfarë krijonte shpenzimet e mëdha, së pari për SHKIP, por edhe për qytetarët dhe për ekonominë. Duke konsideruar faktin se Budva është lideri i turizmit malazez, aq më tepër ka ekzistuar nevoja e shtuar që pastërtia komunale të mbahet në nivelin e parashikuar me standarde të Bashkimit Evropian. Ashtu Komuna e Budves ishte e obliguar që përpos zgjidhjes së problemit me vendin për deponimin e mbeturinave komunale paraprakisht t’ a fillojë dhe t’ a realizojë projektin e grumbullimit të seleksionuar të mbeturinave dhe riciklimin e tyre.

Me projekt është parashikuar realizimi i qëllimeve vijuese:

- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e mjedisit të shëndoshtë dhe mbrojtës së mjedisit jetësor;
- Zhvillimi i sistemit të ri dhe të qëndrueshëm të vlerave ekologjike përmes përfshirjes së fëmijëve në projekt;
- Zhvillimi i vetëdijes dhe edukimi i qytetarëve mbi mënyrat dhe standardet evropiane të

deponimit të mbeturinave komunale (seleksionimi) në kontekstin e zgjidhjes së ardhshme të qëndrueshme në mënyrën e deponimit të mbeturinave të forta komunale në formë të fabrikës për grumbullimin dhe riciklimin në komunën e Budves;

- Zhvillimi i mbështetjes së qytetarëve në mënyrë të grumbullimit të seleksionuar të mbeturinave të forta;
- Zvogëlimi i shpenzimeve të ndërmarrjes komunale SHKIP Budva në kontekstin e zvogëlimit të shërbimeve të faturuara ekonomisë dhe qytetarëve;
- Realizimi i të ardhurave nga shitja e lëndëve të dyta – letrës;
- Bashkëpunimi i OJQ dhe qeverisjes lokale në instalimin e zgjidhjeve të reja dhe zgjidhjen e problemit të deponimit të mbeturinave të forta komunale;
- Modelimi i mundësive të ndikimit të qytetarëve tek vendimmarrja dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale.

Projekti „Mblidhe që mos të hidhet“ është realizuar në dy pjesë. Pjesa e parë është referuar vendosjes së truallit për riciklim dhe kanalit të shitjes së lëndëve të dyta (letrës) të bashkuara, ndërsa pjesa e dytë është referuar promovimit të vlerave ekologjike, edukimit në lidhje me mbeturinat e forta komunale dhe ngritjes së vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e grumbullimit të seleksionuar të mbeturinave komunale dhe riciklimit.

Gjatë realizimit të projektit janë ndërmarr aktivitetet vijuese:

- Nga SHKIP u vendos truall për riciklim që nënkuptonte hangarin e mbuluar dhe presën për letër për qëllim të presimit dhe magazinimit të letrës;
- Në bashkëpunim me Ministrinë e planifikimit hapësinor dhe zhvillimit të qëndrueshëm janë blerë 50 kontejnerë – të specializuar për grumbullimin e letrës, ndërsa SHKIP ka bërë vendosjen dhe shpërndarjen e tyre në komunën e Budves, duke konsideruar strukturën e ndërmarrjeve të mëdha hoteliere dhe tregtare si dhe dendësinë e popullsisë;
- U zbatua fushata publike nëpër media lokale (intervista, konferenca për shtypin, pjesëmarrja në studio, emisionet e specializuara) për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve mbi rëndësinë e riciklimit, si dhe shpërndarja e fletëpalosjeve (500 copë) dhe posterave (50 copë) nga OJQ „iniciativa e pavarur qytetare“ dhe OJQ „Green.me“;
- Kamionit ekzistues për grumbullimin e mbeturinave të SHKIP Budva iu ndërrua funksioni në kamion për grumbullimin e letrës;
- U vendos bashkëpunimi profesional me ndërmarrjen që merret me riblerjen e lëndëve të dyta;
- U avancua informimi i qytetarëve dhe i ekonomisë mbi ekzistimin e kontejnerëve me qëllim të posaçëm përmes vendosjes së tabelave informuese, dhe kjo fushatë ishte përgjegjësia e ndërmarrjes „Advertising group“.

Sa i përket komponentit edukativ është synuar promovimi i vlerave ekologjike dhe ngritja e vetëdijes mbi rëndësinë e grumbullimit të seleksionuar të mbeturinave komunale dhe e riciklimit. Në këtë pjesë kanë kontribuar shumë tri OJQ që janë partnerë në projekt (OJQ „Iniciativa e pavarur qytetare“, OJQ „Eko forum“, OJQ „Green.me“) në mënyrë që janë organizuar tri ligjërata në tri shkolla fillore me temë „Rëndësia e grumbullimit të seleksionuar të mbeturinave dhe e riciklimit“ dhe në këtë mënyrë janë edukuar rreth 250 nxënës. Gjatë ligjëratave, nxënësve janë shpërndarë fletëpalosjet me harta të kontejnerëve për letër. Përpos këtyre, të tri OJQ gjatë realizimit të projektit kanë organizuar katër aksione të posaçme të grumbullimit të letrës së vjetër nëpër shkolla të Budves, dhe aksionet posaçërisht janë pasuruar me shpërndarjen e çmimeve që i pasiguroar Komuna e Budves.

Gjatë kohës së realizimit të këtij projekti ka ardhur deri tek zvogëlimi i sasisë së mbeturinave komunale dhe deri tek zvogëlimi i shpenzimeve të ndërmarrjes komunale. Projekti është vazhduar me zgjerimin në grumbullimin e seleksionuar të plastikës, kanaqeve dhe qelqit. Mjetet janë siguruar nga shitja e letres së vjetër dhe llojeve të tjera të lëndëve të dyta të grumbulluara. Përpos rezultateve të shumta të dukshme, ky projekt paraqet konceptin e shkëlqyer të bashkëpunimit të organizatave joqeveritare dhe qytetarëve me qeverisjen publike dhe sektorin publik lidhur me çështje nga rëndësia zhvillimore për një komunë turistike, përmes avancimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve dhe ambientit të përgjithshëm biznesi.

Komuna e Kotorit

TITULLI I PROJEKTIT: „Përforcimi i kapaciteteve për ngritjen e transparencës së Komunës së Kotorit”

Mbartësi i projektit: OJQ, „Qendra për tranzicionin demokratik” (CDT)

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Projekti i përbashkët i Komunës së Kotorit dhe Qendrës për tranzicionin demokratik (CDT) me titull “Përforcimi i kapaciteteve për ngritjen e transparencës së Komunës së Kotorit” u iniciua nga kjo organizatë joqeveritare me qëllim të zgjidhjes së problemeve siç janë kapacitetet jo mjaft të zhvilluar të administratës komunale në luftë kundër korrupsionit, transparenca e pamjaftueshme e punës së komunës dhe organeve komunale, por edhe shkalla e ulët e informimit të qytetarëve mbi aktivitetet që i realizon administrata e qytetit. Komuna e Kotorit është njohur si partner i mirë në projekt duke konsideruar se është e vlerësuar si vetëqeverisje lokale me praktikë shumë të mirë në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, por dhe si ajo që ka cilësinë e mirë të internet prezantimit me informacione të disponueshme që përditësohen dhe shpallën për çdo ditë. 78,98% të projektit u financua nga Partnership for Transparency Fund (PTF) në shumë prej 27,480,00 USD, ndërsa pjesën tjetër e ka financuar Qendra për tranzicionin demokratik.

Pas formimit të ekipit të projektit të përbërë nga përfaqësuesit e CDT-së dhe administratës komunale, përmes analizës së legjislacionit të administratës komunale dhe shërbimeve të tyre që i ofrojnë qytetarëve, janë konkretizuar problemet e kësaj komunë. Gjatë vizitës dyditore në Komunën e Rijekes u vendos bashkëpunimi formal me këtë qytet si një nga liderët rajonal në fushën e transparencës së administratës komunale, ndërsa bisedimet me përfaqësuesit e Administratës komunale dhe sektorit joqeveritar në Rijeka ishin jashtëzakonisht të dobishëm për përfaqësuesit e komunës dhe të CDT-së. Poashtu, në bazë të platformave të shkëmbyera me Komunën e Rijekes u përpilua strategjia komunale për luftë kundër korrupsionit. Përpos kësaj, u organizua një seri e tribunave dhe evenimenteve komunale që në mënyrë adekuate të prezantohen ndryshimet kryesore në procedura komunale, dhe qytetarët u informuan më tepër mbi aktivitetet e komunës edhe përmes mediave lokale, ueb faqeve të komunës dhe të CDT-së, si dhe përmes buletinit mujor që u shtyp dhe u shpërnda në territorin e komunës së Kotorit.

Përpos zgjidhjes së problemeve të përmendura, praktika e mirë njëkohësisht ka pas për qëllim promovimin e bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe zgjerimin e bashkëpunimit rajonal përmes projekteve të përbashkëta, shkëmbimit të dijenisë dhe përvojës praktike. Përpos këtyre, u përmirësua shumë dhe vetëdija e qytetarëve dhe të punësuarve

në administratë komunale mbi rëndësinë e transparencës si obligimit, çfarë paraqet ndikimin tek përmirësimi i gjendjes në tërë sistemin e vetëqeverisjes lokale.

Komuna e Nikshiqit

TITULLI I PROJEKTIT: „Përforcimi i transparencës së punës së organëve të administratës lokale dhe përfshirja më e madhe e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”
Bashkëpunëtori në projekt: OJQ „E ardhmja më e mirë”

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Projekti „Përforcimi i transparencës së punës së organeve të qeverisjes lokale dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes” u realizua në kuadër të projektit „Përforcimi i transparencës dhe i përgjegjësisë në nivelin lokal”, i implementuar nga Asociacioni i komunave të Holandës (VNG International) dhe Shoqata e Bashkive të Malit të Zi, dhe u financua nga MATRA programi i Ministrisë së Jashtme të Holandës.

Konkretisht, studimi që e zbatoi Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare, me mbështetje të Ulof Palme dhe Shoqatës së Bashkive të Malit të Zi, tregoi pakënaqësinë me nivelin e bashkëpunimit si tek qytetarët, ashtu dhe tek përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale. Si problemet kryesore në këtë kuptim kanë identifikuar:

- informimin e pamjaftueshëm të qytetarëve mbi mekanizmat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes,
- përfshirja e pamjaftueshme e përfaqësuesve të OJQ-ve në punën e trupave punues, si dhe
- shkalla e ulët e pjesëmarrjes si qytetarëve ashtu dhe përfaqësuesve të OJQ-ve në diskutime publike.

Në pajtim me këtë, iniciativën për zgjidhje të këtij problemi e ka nisur Shërbimi i Kryetarit të Komunës në bashkëpunim me përfaqësuesit e OJQ që poashtu ishin të përfshirë në realizimin e këtij projekti.

Implementimi i projektit ka zgjatur 6 muaj, dhe janë investuar mjetet në shumë prej 12.916,82 euro. Aktivitetet më të rëndësishme të projektit që janë realizuar nga përfaqësuesit e Komunës së Nikshiqit përmes bashkëpunimit me këshilltarin dhe përfaqësuesin e OJQ “E ardhmja më e mirë” janë:

- Hartimi i Strategjisë së komunikimit,
- Vendosja e bazës për formimin e Qendrës informative, si dhe
- Hartimi i Doracakut mbi mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Strategjia e komunikimit përmban udhëzimet kryesore për perfeksionimin e komunikimit të vetëqeverisjes lokale me qytetarët, organizata joqeveritare, ndërmarrësit, mediat, organet shtetërore, por edhe për përmirësimin e komunikimit të brendshëm ndër-sektorial mes zyrtarëve dhe sekretariateve. Gjatë hartimit të Strategjisë së komunikimit të cilën e kanë punuar përfaqësuesit e qeverisjes lokale, këshilltari dhe përfaqësuesi i OJQ “E ardhmja më e mirë”, janë mbajtur disa fokus grupe me përfaqësuesit e OJQ, mediave, zyrtarët dhe nëpunësit e organeve të qeverisjes lokale, si dhe me të punësuarit në institucione dhe ndërmarrje publike themeluesi i të cilëve është Komuna e Nikshiqit.

Në bazë të të dhënave të fituara u përpilua analiza e situatës dhe lani i aksioneve. Pas hartimit të Projekt strategjisë u mbajt diskutimi publik që zgjati 15 ditë si dhe tribuna përfundimtare, dhe të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet mbi Projekt strategjinë janë pranuar dhe janë inkorporuar në dokument. Hartimi i Strategjisë së komunikimit, të cilin e përcjelli fushata në media, krijoi parakushtet për avancimin e mëtejshëm të transparencës dhe të përgjegjësisë së punës së vetëqeverisjes lokale.

Për nevoja të hartimit të Doracakut për qytetarët mbi mekanizmat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal dhe për instalimin e rrjetit kompjuterik u angazhuan ekspertet e jashtëm. Me hartimin e Doracakut të përmendur, që u shtyp në 1000 kopje, së bashku me materialin promovues (fletëpalosjet), me promovimin dhe shpërndarjen e tij, u përmirësua informimi i qytetarëve njëkohësisht dhe pjesëmarrja e tyre në diskutime publike, tribuna, punën e trupave punues, etj.

Me instalimin e pajisjeve në Qendrën informative, formimi i të cilës paraqet aktivitetin e posaçëm të projektit, u përmirësua cilësia e qarkullimit të informacioneve. Me fjalë të tjera, me hartimin sistemit strukturor të kabllave u mundësua rrjetimi i kompjuterëve mes Byrosë qytetar, Zyrës së gjendjes civile dhe kateve të veçantë dhe u krijua lidhja elektronike duke lehtësuar në këtë mënyrë komunikimin mes organeve të qeverisjes. Përpos këtyre, ueb faqja u rregulla deri në detaje në mënyrë që të gjithë të interesuarve t'i ofroj informacionet mbi punën e qeverisjes lokale, mbi kompetencat e organeve të qeverisjes si dhe mbi procedurat që përdoren gjatë realizimit të ndonjë të drejtës apo shërbimit të caktuar.

Me realizimin e aktiviteteve të lartpërmendura përmes projektit „Përforcimi i transparencës së punës së organeve të qeverisjes lokale dhe përfshirja më e gjerë e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes”, përpos qëllimeve të realizuara të projektit, u arritën edhe rezultatet e konsiderueshëm në kuptimin e pranimit të mënyrave të reja të komunikimit, si mes vetë zyrtarëve në organe të qeverisjes, ashtu dhe mes organeve të qeverisjes dhe elementeve të jashtëm, me çfarë përfundimisht dhe sigurohet qëndrueshmëria e praktikës së mirë.

Komuna e Plevles

TITULLI I PROJEKTIT: „Info buletini”

Partneri në projekt: OJQ, „Shoqata e të rinjve”

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Në kuadër të projektit “Ngritja e përgjegjësisë dhe e transparencës në nivelin komunal në Republikën e Malit të Zi”, që e zbatuan VNG INTERNATIONAL dhe Shoqata e Bashkive të Malit të Zi, që u financua nga Ministria e Jashtme e Holandës në kuadër të Programit të transformimit shoqëror të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (MATRA), u iniciua Info buletini i komunës së Plevles. Partneri në realizimin e këtij projekti ishte organizata joqeveritare „Shoqata e turinjve” nga Plevle.

Përveç faktit se Komuna e Plevles përmes përditësimit të ueb faqes dhe përmes mediave i informon qytetarët dhe sektorin joqeveritar mbi aktivitetet e veta të rregullta, Info buletini është i njohur si një formë e informimit të shtuar të qytetarëve dhe nxitjes së pjesëmarrjes së tyre më aktive në procesin e përgatitjes, miratimit dhe hartimit të dokumenteve, planeve dhe projekteve zhvillimore. Me iniciimin e Info buletinit, Komuna e Plevles ka pas qëllim që të gjithë përbërësit e vetëqeverisjes

lokale, në veçanti qytetarët, të janë të informuar me kohë, saktësisht dhe falas mbi funksionimin e institucioneve komunale, por edhe mbi të gjitha çështjet të rëndësishme nga interesi i popullsisë.

Pas pranimit të këtij projektit, u formua redaksia e Info buletinit e përbërë prej kryeredaktorit dhe tre anëtarëve që me profesionalizmin dhe eksperiencën e vetë shumëvjeçare si gazetarë në shtyp dhe në media elektronike kanë kontribuar rëndësisht realizimit të projektit. Pjesa e parë e punës së tyre është referuar grumbullimit të të dhënave përmes anketimeve mbi temat mbi të cilat qytetarët kanë dëshirë të informohen më thellësisht, ndërsa në pjesën e dytë u definua përmbajtja dhe dizajni i vetë buletinit. Përpos anëtarëve të redaksisë, në përgatitjen e përmbajtjes së Info buletinit kontributin e konsiderueshëm kanë dhanë dhe të gjitha shërbimet dhe sekretariatet komunal që kanë dërguar të dhënat mbi aktivitetet e veta për t' i aktualizuar njëkohësisht temat e trajtuara.

Gjatë realizimit të projektit janë shtypur gjithsej tre numra. Info buletini e ka rritur informimin e qytetarëve, kryesisht të atyre nga zonat rurale, duke konsideruar faktin se nga tirazhi i përgjithshëm rreth 40% është shpërnda në zonat fshatare të komunës. Realizimi i këtij projekti ka ndikuar shumë tek transparenca dhe përgjegjësia e punës së organeve të qeverisjes lokale sepse janë botuar dhe dokumentet më të rëndësishëm siç janë buxheti, plani investues shumëvjeçar, etj. Përveç kësaj, Info buletini e kishte rolin që t' i edukoj qytetarët mbi të drejtat dhe obligimet e tyre ligjore.

Vlera e projektit i cili u zbatua 9 muaj ishte rreth 11.000euro, prej të cilës shumë 8.000 euro ishte donacioni i VNG International, ndërsa mjetet tjera i ka siguruar Komuna e Plevles.

Komuna e Bijello Poles

TITULLI I PROJEKTIT: „Hapja e Byrosë qytetare“

Partneret në projekt: OJQ „Modus Acquirendi“, Zyra për të rinjtë e Komunës së Bijello Poles

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Projektin “Hapja e Byrosë qytetare” Komuna e Bijello Poles e ka realizuar në partneritet me OJQ „Modus Acquirendi”, Zyrën për të rinjtë të Komunës së Bijello Poles, në kuadër të programit „Përforcimi i kapaciteteve të komuniteteve lokale”. Projekti financiarisht u mbështet nga Ministria e Jashtme e Holandës dhe organizata holandeze VNG, me bashkëpunim të plotë të Shoqatës së Bashkive të Malit të Zi. Me realizimin e këtij projektit qytetarëve të Bijello Poles u mundësua që në mënyrë më të lehtë, në kuadër të shërbimeve të Byrosë qytetare të pajisen me udhëzime mbi të drejtat dhe obligimet e veta, të caktojnë takimet dhe t' i marrin të gjitha llojet e informacioneve nga kompetenca punës së shërbimeve.

Para hapjes së Byrosë qytetare, në kërkimin e realizimit të të drejtave dhe obligimeve të veta, palët duhej të vizitojnë zyrat dhe nëpunësit që janë vendosur jo vetëm në ndërtesën kryesore të komunës, por edhe në ndërtesa të ndara dhe që janë edhe ka 1 km larg, çfarë ka krijuar konfuzion të shtuar dhe ngarkesë, posaçërisht personave të moshuar. Pikërisht për këtë arsye u iniciua ideja e Byrosë qytetare për t' i zgjidhur në mënyrë adekuate problemet e përmendura, por edhe problemet e mosnjohjes së procedurave nga qytetarët dhe problemet e kërkesave të paplota që kanë shkaktuar jo vetëm shkeljen e afateve administrative por edhe pritjen e panevojshme për qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të veta.

Qëllimi i projektit ishte që të mundësohet qytetarëve në mënyrë infrastrukturore dhe edukative t' i realizojnë të gjitha nevojat e veta në një vend me një mesazh të qartë që nëpunësi i administratës lokale punën e vetë e kryen për qytetarët e Bijello Poles dhe në atë mënyrë e arsyeton pagën mujore që ia mundësojnë vetë qytetarët përmes të ardhurave lokale. Byroja qytetare përbehet prej gjashtë sporteleve ku punojnë nëpunësit e trajnuar për punën e vetë, që së bashku me pranimin e kërkesave kryejnë edhe komunikimin e dyanshëm në kuptimin e edukimit të qytetarëve mbi të drejtat dhe obligimet re tyre, dhe poashtu u ndihmojnë konkretisht në plotësimin e kërkesave. Më këtë Byro gjithë është sistematizuar në një vend dhe është ndaluar “endja” e palëve nga zyra në zyre, dhe përveç kësaj lokacioni i Byrosë është me rëndësi të posaçme për qasje të papenguar personave me invaliditet duke patur para sysh se nuk ekzistojnë barrierat arkitektonike.

Në këtë projekt janë investuar mjetet në shumë prej 35.000 euro. Mjetet janë investuar kryesisht në adaptimin e hapësirës për vendosje të Byrosë qytetare dhe furnizimin me pajisje të nevojitur për punën e nëpunësve të Byrosë. Përveç këtyre, janë trajnuar pesë nëpunës për punë në Byro dhe gjatë trajnimeve vëmendja e posaçme është kushtuar marrëdhënieve me qytetarët dhe mënyrave të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal. Për qëllime të informimit dhe të edukimit të qytetarëve janë shtypur 10000 broshura – mbi mënyrën e punës dhe kompetencat e shërbimeve dhe organeve të qeverisjes lokale, 20000 fletëpalosje – mbi mënyrën e funksionimit të Byrosë qytetare, dhe janë shtypur 100 postera për qëllime të informimit të qytetarëve mbi fillimin e punës së Byrosë qytetare.

Ideja e Byrosë qytetare është mirëpritur nga qytetarët e Bijello Poles, dhe në atë kuptim qëndrueshmëria e tij është e garantuar. Poashtu, në mënyrë organizative është siguruar me sistematizimin si njësi e posaçme në kuadër të Sekretariatit për veprimtaritë shoqërore, dhe nuri i përgjigjeve në kërkesa brenda afateve administrative është për 40% më i madh në krahasim me periudhë para inicimit të këtij projekti.

Komuna e Tivatit

TITULLI I PROJEKTIT: „Përgatitja e fëmijëve të popullsisë RAE për shkollë në Komunën e Tivatit”

Partnerët në projekt: Shoqata e Egjiptianëve, Kryqi i Kuq

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Qëllimi kryesor i projektit që e ka realizuar Komuna e Tivatit në bashkëpunim me Shoqatën e Egjiptianëve dhe Kryqin e Kuq, që u financua nga UNDP – Zyra në Mal të Zi, ka qenë që fëmijët të popullsisë RAE në mënyrë adekuate të përgatiten për shkollimin e rregullt dhe ashtu të ngritët edhe numri i fëmijëve të regjistruar në shkollën fillore dhe të sigurohet qëndrimi i tyre në shkollë dhe ndjekja e rregullt e procesit arsimor.

Në pajtim me qëllimin e projektit, së pari është organizua takimi iniciues me fëmijët dhe me prindërit e tyre, pastaj u zhvillua “testimi hyrës”. Do të thotë, të gjithë fëmijët janë testuar në bazë të “testit hyrës” që ka qenë i përshtatur moshës së tyre, i përgatitur nga ekipi profesional i përbërë nga edukatorja dhe pedagogu i shkollës. Në bazë të rezultateve të testit dhe dijenisë së vlerësuar të gjuhës, shprehive dhe dijenisë së përgjithshme, edukatorja e ka zhvilluar programin e punës në

pajtim me programin zyrtar të Ministrisë së arsimit dhe shkencës së Malit të Zi. Hapi vijues në realizimin e projektit ishte organizimi dhe mbajtja e mësimit përgatitor, dhe për këtë aktivitet ishin të detyruar edukatori profesional dhe asistenti. Mësimi është mbajtur dy herë në javë duke u përcjellë me takime të rregullta me prindërit, në pajtim me programin e punës të përcaktuar. Në fund u zbatua dhe testimi përfundimtar – pas përfundimit të mësimit përgatitor ekipi profesional i përbërë nga edukatorja dhe pedagogu i shkollës e ka përgatitur testin përfundimtar, të përshtatur moshës së fëmijëve në bazë të cilit janë testuar gjithë fëmijët që kanë ndjekur mësimin përgatitor.

Me këtë projekt u përfshinë 28 fëmijë prej të cilëve 25 janë regjistruar në shkollë fillore dhe rregullisht e ndjekin mësimin edhe sot, ndërsa tre prej tyre që poashtu e kanë ndjekur mësimin janë shpërngul në Kosovë. Fëmijët që e kanë kaluar mësimin përgatitor shumë lehtë janë përshtatur mësimit në shkollë fillore.

Projekti i përgatitjes së fëmijëve të popullsisë RAE ka pas një jehonë pozitive në gjithë komunitetin dhe ka ndikuar tek realizimi i qëllimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte të individëve, familjeve të tyre, por edhe grupit në përgjithësi.

Problemi i arsimimit për popullsinë RAE është problemi mbi të cilin mbështeten të gjitha problemet tjera, problemi i socializimit, i punësimit, i përdorimit të përfitimeve nga programi për grupet shoqërisht të marginalizuara, si dhe përfitimeve të shumta që shteti i ofron, por mbi të cilat duhet të janë të informuar për të pas mundësinë të përshihen.

Pasojat janë të gjera, jo vetëm kur bëhet fjala për përfshirjen e fëmijëve të përgatitur në programin mësimor, por edhe socializimi i fëmijëve që deri në këtë kohë kanë jetuar të izoluar në lagje të tyre dhe që ishin të përjashtuar nga të gjitha sferat e jetës shoqërore. Plani lokal i përfshirjes së popullsisë RAE në Komunën e Tivatit është zhvilluar, mbështetet në Planin e aksionit kombëtar të implementimit të “Dekadës së përfshirjes së Romëve 2005 – 2015”, ashtu që është hartuar analiza e situatës më bashkëpunim me OJQ Cikli Rom dhe me Shoqatën e Egjiptianëve, që ka shërbyer si baza për hartimin e Projekt Planit lokal të përfshirjes së popullsisë RAE në Komunën e Tivatit. Më këtë Komuna e Tivatit edhe një herë ka treguar se bashkëpunimi mes vetëqeverisjes lokale dhe sektorit joqeveritar mund t’i japin rezultatet e shkëlqyera dhe se e meriton epitetin e komunës e cila i korr sukseset më të mëdha në Mal të Zi në fushën e bashkëpunimit me sektorin joqeveritar.

Komuna e Beranes

TITULLI I AKTIVITETIT: „Iniciativa për ndërtimin e azilit për kafshët e braktisura “
Nismëtarët e iniciativës: OJQ „Feniks”, OJQ „Hapi i shpresës“, OJQ „Toleranca”

PROJEKTI: „Shoqëria civile dhe vetëqeverisja lokale në përforcimin e kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe Mal të Zi”

MBARTËSIT E PROJEKTIT: Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO) dhe Qendra për ndryshime dhe zgjidhjen e konflikteve nga Shqipëria (PARTNERS)

Përshkrimi i shembullit të praktikës së mirë:

Qendra për zhvillimin e organizatave joqeveritare (CRNVO) në partneritet me Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti (PSh) në maj të vitit 2012 ia ka fillua me realizimin

e projektit „Shoqëria civile dhe vetëqeverisja lokale në përforsimin e kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe Mal të Zi”. Projekti i bashkëpunimit ndërkuftar mes Malit të Zi dhe Shqipërisë u financua nga Bashkimi Evropian, nga komponenti i dytë i Instrumentit për ndihmë para-aderimi 2007 – 2013. Qëllimi kryesor i projektit është shkalla më e lartë e integritimit, e zhvillimit dhe e bashkëpunimit të shoqërisë civile në fushën e përforsimit të kohezionit shoqëror në Shqipëri dhe Mal të Zi. Përveç këtyre, projekti synon ngritjen e nivelit të shkëmbimit të ideve dhe dijenisë, si dhe bashkëpunimit mes organizatave të shoqërisë civile, grupeve shoqërore dhe vetëqeverisjes lokale nga dy vendet.

Në pajtim me qëllimet e projektit, u realizuan aktivitetet për përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, individët aktiv dhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale nga katër qytete malazeze (Tivar, Danillovgrad, Plavë dhe Berane) dhe katër qytete shqiptare (Kopliku, Bushati, Vau i Dejës dhe Dajç). Duke marrë pjesë në aktivitetet e projektit, përfaqësuesit e vetëqeverisjeve lokale dhe organizatave joqeveritare nga dy vendet kanë pas mundësi t’i përforsojnë kapacitetet e veta në fusha të përfaqësimit publik, mobilizimit të komunitetit, inkluzionit social. Përveç këtyre, pjesëmarrësve të projektit u mundësua zgjerimi i dijenive të tyre mbi mekanizmat dhe modelet e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal, si dhe mbi mënyrat përmes të cilave mund t’i zbatojnë monitorimin e zbatimit të vendimeve të miratuara dhe politikave publike në përgjithësi.

Në muajin shtator të vitit 2012 në Danillovgrad u organizua trajnimi dyditor me temë “Pjesëmarrja qytetare në nivelin lokal”. Qëllimi i trajnimit ishte njohja e pjesëmarrësve me mënyrat dhe mekanizmat përmes të cilëve qytetarët në Mal të Zi dhe në Shqipëri mund të marrin pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe të implementimit të politikave publike në nivelin lokal. Trajnimi i ka përfshirë pjesët teorike dhe praktike, dhe gjatë trajnimit janë përdorur teknikat që nxisin dhe mundësojnë mësimin nga eksperiencia. Prezantimi, diskutimi dhe puna në grupe punuese u kanë mundësuar pjesëmarrësve përdorimin e stileve të ndryshme dhe në atë mënyrë kanë nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive. Që mësimi nga eksperiencia të arrijnë efektin e plotë dhe që pjesëmarrësit nga trajnimi të shkojnë me “prodhime të gatshme”, ata ishin të ndarë në 4 grupe dhe gjatë trajnimit kanë punuar në përgatitjen e iniciativave, një nga mekanizmat kryesor të pjesëmarrjes qytetare në procesin e vendimmarrjes. Një nga këto iniciativa u pranua nga vetëqeverisja lokale dhe ajo ishte “Iniciativa për ndërtimin e azilit për kafshët e braktisur” në Komunën e Beranes.

Me fjalë tjera, në Komunën e Beranes viteve të fundit ka ardhur deri tek ngritja e përshpejtuar e numrit të qeneve endacak. Kriza ekonomike që e ka goditur mbarë popullsinë malazeze ka ndikuar, mes tjerash, edhe tek ky fenomen. Mungesa e mjeteve financiare ka kushtëzuar pamundësinë e shumë familjeve që t’i ushqejnë qenat. Por, shkaku kryesor i lajmërimit të këtij fenomeni është mosekzistimi i strehimit për kafshët e humbura. Pasojat e mosekzistimit të strehimit brengosin shumë. Është fakti se është rritur dhe numri i lajmërimeve mbi lëndimin e njerëzve nga qentë endacak. Duke konsideruar se bëhet fjala mbi kafshët që nuk janë të përfshira me mbrojtjen shëndetësore, rreziku nga kalimi i sëmundjeve është i madh, dhe poashtu janë të shpeshta rastet kur qentë i shpërhapin mbeturinat. Lëvizja e pakontrolluar e qeneve endacak si pasojë ka uzurpimet, në kuptimin e hyrjes së tyre nëpër hyrje të godinave dhe nëpër oborret e shtëpive, si dhe nëpër hapësirat të kushtuara për lojë të fëmijëve. Gjitha këto drejtpërdrejt kërcënojnë shëndetin fizik dhe psikik të njerëzve.

Me qëllim të zgjidhjes së fenomeneve të palejuara evidente (lëvizja e pakontrolluar e qeneve endacak, qentë jo të vaksinuar, qentë e pashënuar, mungesa e objektit për strehim të kafshëve të braktisura, etj.) u propozua ndërtimi i azilit për kafshët, në zonë jashtë tërësisë urbane.

Përfaqësuesit e OJQ-ve të përmendura pas grumbullimit të 500 nënshkrimeve, e kanë dorëzuar

iniciativën Sekretariatit për rregullimin e hapësirës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor të Komunës së Beranes, por duke konsideruar se ky organ nuk e ka shqyrtuar iniciativën në afatin e duhur, parashtruesit e kanë përdorur të drejtën e vetë dhe janë drejtuar Kryetarit të Komunës, Vuka Golluboviqit. Ka vijuar përgjigja pozitive nga kabineti i Kryetarit të Komunës, dhe atij rasti është theksuar se para marrjes së çfarëdo vendimit duhet të zbatohen diskutimet publike, për t' i dëgjuar propozimet dhe sugjerimet nga qytetarët, institucionet relevante, organizatat dhe shoqatat. Azili për kafshët e braktisura do duhej të ndërtohet në lagjen Talum, në periferi të qytetit. Duke pas para sysh se aty ekziston një kopsht zoologjik privat i vogël, ideja është që ai të rindërtohet në një kopsht zoologjik më modern në kuadër të cilit do të ishte vendosur azili për kafshët e braktisura. Për qëllim të realizimit të kësaj iniciative, Komuna e Beranes është duke zhvilluar negociata edhe me Agjencinë për ruajtjen e mjedisit jetësor, ashtu që ekziston mundësia reale që kjo iniciativë do të bëhet shembull i praktikës së mirë të bashkëpunimit mes sektorit joqeveritar dhe vetëqeverisjes lokale.

3.2. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË BASHKËPUNIMIT MES QYTETARËVE DHE VETËQEVERISJEVE LOKAL NË SHQIPËRI

Bashkia e Kuçovës

TITULLI I AKTIVITETIT: „Komisioni Këshillimor Qytetar i Bashkisë Kuçovë“
Nismëtarët e iniciativës: Bashkia Kuçovë, USAID

Bashkia Kuçovë e ka krijuar Komisionin Këshillimor Qytetar në Maj të vitit 1998 me asistencën teknike të projektit PAP/A-USAID kur ende nuk ishte miratuar ligji 8652, dt.31.07.2000, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore” që rregullonte aktivitetin e kësaj të fundit. Bashkia Kuçovë ndjente nevojën e komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe zhvillimin ekonomik sepse jashtë bashkisë kishte ekspertë dhe specialistë shumë të mirë të fushave të ndryshme që mund të jepnin kontributin e tyre.

Qëllimi i krijimit të KKQ ka qenë:

- Hartimi i Planit të Investimeve Kapitale
- Diskutimi i Planit Strategjik për Zhvillimin Ekonomik
- Përcaktimi i Projekteve Prioritare
- Diskutimi i projekt/buxhetit dhe buxhetit para miratimit në Këshillin Bashkiak
- Diskutimi i Paketës Fiskale dhe Tarifave
- Diskutimi i Planeve për përmirësimin e shërbimeve dhe standardizimin e tyre
- Miratimi i buxhetit vjetor
- Diskutimi për probleme të ndryshme që ishin në interes të komunitetit, si diskutimi i Studimeve Urbanistike etj.

Komisioni Këshillimor Qytetar është një komision vullnetar dhe këshillues i kryetarit të bashkisë. Ai është një komision fleksibël, krijohet në fillim të vitit dhe rifreskohet vit për vit. Antarësia varjon nga 30-35 persona, dhe antarë të Komisionit përzgjidhen persona që kanë integritet dhe dëshirë

për të punuar për qytetin e tyre dhe që përfaqësojnë profesione, kultura dhe mosha të ndryshme, grupe të margjilizuara, pakicat, etj.

Deri në vitin 2012, KKQ propozohej nga Kryetari i Bashkisë dhe në fillim të çdo viti bëhej një takim ku të dy palët binin dakord të bashkëpunonin për të mirën e komunitetit. Komisioni këshillimor funksiononte pranë kryetarit të bashkisë. Ai kishte funksion këshillimor dhe jo vendimmarrës. Në këtë komision diskutoheshin problemet dhe propozimet para se të shkonin për miratim në Këshillin e Bashkisë.

Për vitin 2013, u futën dy elementë të rinj në dinamikën e KKQ: komisioni i propozuar nga kryetari i bashkisë miratohet në Këshillin Bashkiak, dhe ky i fundit ka të drejtë të bëjë ndryshime në këtë listë dhe të miratojë një rregullore funksionimi të KKQ, që përcakton funksionet, detyrat dhe të drejtat e këtij komisioni. Miratimi i këtij komisioni në Këshillin Bashkiak, e institucionalizon dhe i rrit përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë këtij komisioni, por gjithashtu edhe Këshilli Bashkiak bëhet më i përgjegjshëm për procesin e bashkëpunimit me komunitetin.

Në maj të këtij viti u bënë 15 vjet të aktivitetit të Komisionit Këshillimor Qytetar. Ndër arritjet dhe kontributet kryesore të tij ndër vite listohen:

- Diskutimi i përvitshëm i paketës fiskale që është një element shumë i ndjeshëm për qytetarët, e ku kontributi i komisionit ka qenë vecanërisht i nevojshëm dhe mbështetës sa i përket propozimeve për tarifën e shërbimeve dhe grumbullimet e tyre.
- Hartimi i plan buxheteve me më shumë se një variant, ku përveç variantit të përgatitur nga stafi i bashkisë, Këshilli Bashkiak i paraqitet dhe varianti me ndryshimet/rekomandimet e bëra nga Komisioni Këshillimor. Më pas është Këshilli që merr një vendim dhe miraton.
- Rishikimi dhe miratimi periodik i Planit Strategjik për Zhvillimin Ekonomik dhe Planit të Investimeve Kapitale.
- Diskutimi në faza të ndryshme i hartimit të Planit Urbanistik.

Komunikimi dhe konsultimi me këtë komision ka bërë që problemet që trajtohen, të përfshijnë gjerësisht mendimin qytetar. Në këtë mënyrë materialet e dokumentat e hartuara së bashku janë më të plota dhe gjithëpërfshirëse, komuniteti është i mirënjohur dhe Bashkia është transparente në veprimet që kryen.

Kjo është shumë e vlefshme vecanërisht për çështje të tilla si tarifën dhe taksat vendore, sepse duke qenë të informuar dhe të përfshirë, qytetarët sqarohen më mirë e puna në terren bëhet më e lehtë. Gjithashtu duke u njohur aktiviteti i bashkisë, edhe vlerësimi i saj nga komuniteti bëhet më real. Bashkia Kuçovë e ka tashmë Komisionin Këshillimor Qytetar një partner bashkërendës dhe krahas takimeve dhe mbledhjeve konsultuese, bashkëpunon me të në shumë drejtime dhe aktivitete të organizuara prej saj.

Bashkia e Durrësit

TITULLI I AKTIVITETIT: “Zyra për Barazinë Gjinore dhe Luftën Kundër Dhunës në Familje”

Nismëtarët e iniciativës: “Shoqata e Grave me probleme Sociale” Durrës, Bashkia Durrës.

Zyra për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje është një ndër zyrat e para të këtij lloji në nivel bashkiak në Shqipëri. Kjo zyrë u hap si rezultat i angazhimit të kryetarit të bashkisë në një nismë

të iniciuar nga “Shoqata e Grave me Probleme Sociale” dhe të shoqatave të tjera në Durrës, të cilat mbështetën këtë iniciativë, e cila u bë realitet 3 Mars 2008.

Disa nga objektivat kryesorë të zyrës për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje janë:

1. Të përmirësojë bashkëpunimin mes institucioneve dhe aktoreve të shoqërisë civile që adresojnë barazinë gjinore në shoqëri.
2. Të rrisë ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi domosdoshmërinë e barazisë gjinore dhe të punojë për të ndryshuar qëndrimet mbi dhunën në familje.
3. Të advokojë për të adoptuar programe të reja me qëllim krijimin e mundësive të barabarta për burrat dhe gratë.
4. Të ofrojë mbështetje rasteve të dhunës në Familje

Ndër funksionet kryesore të kësaj zyre përmendim:

1. Funksion informativ/ burimor mbi çështjet dhe perspektivat gjinore në zhvillimin lokal.
2. Funksion kërkimor / studime mbi barazinë gjinore
3. Funksion advokues / lobues për arritjen e objektivave të komponentit gjinor në çdo çështje komunitare.
4. Funksion koordinues / zhvillues të aktiviteteve në kuadër të projekteve dhe përditshmërisë së punës së saj.
5. Funksion ndërgjegjësues, mbi rendësin, nevojën dhe domosdoshmërinë e përmbushjes së nevojave, përfaqësimit dhe pjesëmarrjen e gruas në jetën aktive të çdo komuniteti.
6. Funksion formues / rritje kapacitetesh të vajzave dhe grave në nevojë.

Zyra e Barazisë Gjinore është përfshirë në organogramën e Departamentit të Shërbimit Social në Bashkinë e Durrësit në sektorin e Shërbimit Social. Në të është punësuar me kohë të plotë Specialistja për Barazinë Gjinore e cila ka për detyrë:

- Të studiojë dhe të përpunojë të dhënat për nevojat, problemet dhe gjithë situatën sociale në qytetin e Durrësit për çështjet gjinore. Të mbrojë gratë në nevojë brenda hapësirave që ofron ligji duke referuar në zinxhirin e sistemit të referimit kundër dhunës në familje të gjithë aktoret e përfshirë. Zyra denoncon pranë organeve të drejtësisë rastet e keqtrajtimit, dhunimit të grave dhe dhunës në familje.
- Të përpilojë draft – projekte për ofrimin e shërbimeve sociale me bazë komunitare në ndihmë të këtij grupi në nevojë në bashkëpunim me OJQ të ndryshme për të dalë në projekte të përbashkëta
- Të advokojë dhe logojë për çështjet e barazisë gjinore në territorin e qytetit të Durrësit.

Aktivitetet e zyrës për Barazinë Gjinore

Zyra u hap në 3 Mars të vitit 2008 pas një procesi të suksesshëm bashkëpunimi të Bashkisë Durrës me “Shoqatën e Grave me probleme Sociale” dhe interesimin e angazhimin e një sërë organizatash që punonin për mbrojtjen dhe fuqizimin e gruas në këtë qytet. Që prej krijimit, Zyra ka asistuar në zbardhjen dhe eliminimin e shumë rasteve të shfrytëzimit për qëllime prostitucioni në bashkëpunim me Policinë e Qarkut Durrës.

Në bashkëpunim me OJQ-të e qytetit, Zyra ka zhvilluar aktivitete periodike në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve. Në bashkëpunim me Shoqatën e Grave me Probleme Sociale, zhvillon çdo vit forumin e hapur për të Drejtat e Grave si fazë e parë hapëse e fushatës ndërgjegjësuere 2 javore kundër dhunës ndaj gruas.

Platforma Strategjike për Koordinimin e Komunitetit është një nga projektet më ambicioze të Zyrës për Barazinë Gjinore. Kjo Platformë synon krijimin e një grupi pune të quajtur “Reagim i koordinuar i komunitetit” (RKK) për të bërë të mundur ndërgjegjësimin mbi ligjin kundër dhunës në familje dhe mbi ligjin e barazisë gjinore dhe mekanizmat e institucionet që e bëjnë të mundur atë, në komunitet.

Në përbërje të RKK janë punonjës bashkiakë dhe nëpunësja e barazisë gjinore, oficerë të policisë së qytetit, përfaqësues të OJFve që punojnë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave etj, Shërbimet Sociale të Bashkisë Durrës, Prokuroria, Gjykata, punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve në Bashkinë Durrës dhe Specialistë të sistemit arsimor, Specialistë të shërbimit shëndetësor, Zyra e punësimin në këtë qytet, të mbijetuara të dhunës në familje që ndajnë përvojën e tyre si dhe përfaqësues të komuniteteve fetare në qytet.

Sukseset:

Bashkia ka mbështetur financiarisht punën e Zyrës për Barazi Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje (përmes botimit të broshurave, fushatave të ndryshme për rritje të ndërgjegjësimin në bashkëpunim me OJF, etj.) në Durrës. Kjo Bashki ka përcaktuar një fond për atë kategori të grave që nuk mund të bëhen pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, dhe falë këtij fondi, aktualisht trajtohen kryefamiljare, gra të veja, nëna me fëmijë jetimë, gra të vetme në moshë pensioni, gra rome dhe egjiptiane etj.

Bashkia nëpërmjet Qendrës Komunitare “Sot për të Ardhmen “ për rastet e dhunës në familje, ofron shërbime falas duke përfshirë: denoncimin e rasteve të dhunës në linjën telefonike 24 orëshe; ofrimin e asistencën psiko-emocionale, shërbimin ligjor për rastet e denoncuar dhe shërbimin psikologjik të asistuar apo edhe transportin në raste nevojë.

Në vijimësi, Zyra në bashkëpunim me aktorë lokalë, OJF etj, organizon aktivitete ndërgjegjëse dhe sensibilizuese për problemet gjinore dhe ato të dhunës në familje.

Bashkia Vau i Dejës

TITULLI I AKTIVITETIT: “Buxhetimi me pjesëmarrje”

Nismëtarët e iniciativës: Bashkia Vau i Dejës

Bashkia Vau i Dejës që nga viti 2008 realizon hartimin e buxhetit duke përfshirë në vendimarrje komunitetin, grupet e interesit, institucionet e tjera dhe shoqërinë civile. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet takimeve konsultative që realizohen gjatë muajit Qershor ndërmjet përfaqësuesve të stafit dhe përfaqësuesve të komunitetit të 8 fshatra dhe në 10 lagje të qytetit.

Në këto takime marrin pjesë në total rreth 150-200 banorë. Kryepërgjigjësja e fshatit, administratori i qytetit dhe këshilltarët janë aktivë në çdo takim.

Në shumë takime, sidomos në lagjet e qytetit marrin pjesë edhe gra, të reja, intelektuale aktive, të cilat japin mendime shumë të vlefshme.

Banorët, grupet e interesit dhe shoqëria civile në këto diskutime shprehin kërkesat, nevojat dhe prioritetet që sipas tyre meritojnë të vlerësohen nga stafi i bashkisë.

Përzgjedhja dhe vënia në listë e nevojave dhe prioriteteve që përfshihen në buxhetin e vitit bëhet së fundmi duke marrë parasysh 5 kritere:

- Objektivat e Strategjisë së Zhvillimit dhe Planit rregullues të Qytetit;
- Prioritetet e miratuara çdo fillim viti në Këshillin Bashkiak;
- Interesin e komunitetit për një investim të caktuar;
- Shpërndarjen e investimeve sipas pagesës së detyrimeve pa lënë pas dore edhe fshatrat që nuk kanë të ardhura por që kanë probleme jetike;
- Premtimet elektorale.

Në procesin e përzgjedhjes angazhohet grupi i punës i caktuar nga Kryetari i Bashkisë, dhe komisionet e këshillit dhe kryesisht komisioni i ekonomisë. Pasi buxheti miratohet në Këshillin bashkiak stafi i komunës dhe Kryetari informojnë komunitetin në seanca dëgjimore me grupe të ndryshme interesi, në takime të hapura të cilat regjistrohen dhe transmetohen në median lokale, nëpërmjet materialeve informuese.

Pas përcaktimit të prioriteteve dhe miratimit të buxhetit të vitit, Kryetari i Bashkisë dhe stafi ndjekin hap pas hapi projektet e miratuara deri në realizimin e plotë të tyre.

Këshilli i Bashkisë informohet vazhdimisht për fazat e realizimit të projekteve dhe luan rolin e monitoruesit gjatë fazës së zbatimit të këtyre projekteve. Qytetarët informohen periodikisht për ecurinë e projekteve nëpërmjet një “grafiku të informimit për publikun” të miratuar në fillim të vitit.

Komuna Dajç

TITULLI I AKTIVITETIT: “Zyra me një Ndalesë”

Nismëtarët e iniciativës: Komuna Dajç, Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim

Objektivi kryesor i nismës për krijimin dhe funksionimin e Zyrës me një Ndalesë (Z1N) ishte përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve.

Mungesa e një strukture informim-komunikimi pranë komunes Dajç bënte që banorët të drejttoheshin disa herë për të njëjtin shërbim duke rritur pakënaqësinë e qytetarëve ndaj shërbimeve administrative të komunës. Metoda e organizmit të punës në menyrë individuale krijonte vështirësi në zgjidhjen efikase të kërkesë/ankesave të banorve duke rritur kohën në marrjen e shërbimeve. Mungesa e mekanizmave të dhënies së një informacioni të shpejtë dhe të monitorueshëm e bënin njësinë e qeverisjes vendore jo shumë transparente për komunitetin. Kjo situatë dhe dëshira e stafit për përmbushjen sa më mirë të detyrave ndaj qytetarëve bëri që të ndërmerreshin hapa për ngritjen e Z1N si zgjidhje efikase ndaj këtyre problemeve.

Zyra me një Ndalesë në Komunën Dajç funksionon që prej Majit të vitit 2009 e në vazhdim, mbi bazën e një rregulloreje të miratuar që prej krijimit të saj duke përmbushur të gjitha objektivat e përcaktuara.

Ajo funksionon me 5 sportele të cilat ofrojnë shërbime të vecanta si:

1. Informacioni - Regjistron kërkesë-ankesa përmes moduleve të instaluara pranë zyrës, informon dhe sensibilizon për çështje të ndryshme banorët, prodhon dhe publikon fletëpalosje informative dhe sensibilizuese etj.
2. Këshillime - Pranë këtij sporteli japin këshillime përgjegjesit e zyrave sipas orareve të percaktuara e të shpallura/njoftuara paraprakisht.
3. Taksat - Pranë këtij sporteli banorët dhe subjektet e biznesit informohen për detyrimet fiskale.
4. Arka.
5. Aksesit i Publikut - Kompjuter me vetëshërbim ku banorët marrin informacione të ndryshme në interes të tyre si psh. Legjislacione e rregullore në lidhje me çështje specifike, të dhëna e statistika nga faqe të institucioneve shtetërore, atyre joqeveritare etj.

Për të parë ecurinë e zyrës realizohet procesi i monitorimit përmes pyetësorëve të cilët plotësohen nga grup moshë të ndryshme që marrin shërbime pranë komunës Dajç para dhe gjatë funksionimit të Z1N. Rezultatet e pyetësorëve tregojnë impaktin pozitiv që ka patur krijimi i kësaj zyre tek qytetarët dhe përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj tyre.

Bashkia Elbasan

TITULLI I AKTIVITETIT: “Buxheti Me Pjesëmarrje në Bashkinë e Elbasanit”

Nismëtarët e iniciativës: Bashkia Elbasan, UN Women

Prej disa vitesh Bashkia e Elbasanit është përpjekur për t’iu përgjigjur më mirë nevojave dhe interesave të qytetarëve të saj. Janë arritur shumë ndryshime pozitive, sidomos në vitet e fundit, falë vullnetit dhe gatishmërisë së zyrtarëve të bashkisë për të punuar së bashku me komunitetin e Elbasanit. Bashkia ndjek një parim të thjeshtë: t’u shërbejë të gjithë qytetarëve, pa dallim nga gjendja socio-ekonomike, gjinia, feja apo bindjet politike.

Buxheti me pjesëmarrje (BP) është një nismë e prezantuar nga bashkia në vitin 2004, me qëllim forcimin e qasjes pjesëmarrëse të qeverisjes vendore në Elbasan. Buxheti pjesëmarrës është një metodë përmes së cilës gratë dhe burrat ndikojnë vendimmarrjen lokale dhe shpërndarjen e burimeve publike për të pasqyruar më mirë nevojat dhe përparësitë e komunitetit. Duke e bërë këtë, Bashkia e Elbasanit përmbush ligjin nr.8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverive vendore”, i cili i detyron njësitet e qeverisë vendore dhe këshillat përkatës që të mbajnë konsultime publike përpara se të kalojnë buxhetin lokal.

Aplikimi i një optike gjinore në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje

Gjatë zbatimit të fazës së parë të këtij procesi, aktorë të ndryshëm vunë në dukje se gratë që merrnin pjesë në takime ishin mesatarisht 15 deri 20 për qind. Kjo solli përcaktimin e çështjeve prioritare, të cilat shpesh nuk pasqyrojnë nevojat dhe shqetësimet specifike të grave. “Kishte lagje ku gratë ngritën disa çështje gjatë takimit, por shqetësimet e tyre nuk u përkufizuan si përparësi për shkak të numrit të vogël të grave që mundën të votonin për përparësitë e tyre”: tha njëri nga pjesëmarrësit në një ndër takimet e mbajtura në lagjet e qytetit.

Pjesëmarrja e barabartë e grave dhe burrave në vendimmarrjen politike është një parakusht për qeverisjen e mire. Megjithatë, shkalla e pjesëmarrjes së grave në proceset politike dhe publike luhet shumë në Elbasan. Për shembull, gratë përbëjnë rreth 47 për qind të administratës bashkiake dhe 36 për qind prej tyre aktualisht mbajnë pozicione drejtuese, përfshirë drejtore departamentesh. Megjithatë, numri i grave të zgjedhura në Këshillin Bashkiak është shumë më i ulët- gratë përfaqësojnë vetëm 15.5 për qind të Këshillit aktual dhe asnjë grua nuk mban një pozicion drejtues në të. Gratë shpesh nuk marrin pjesë në proceset politikëbërëse publike socio ekonomike; edhe kur marrin pjesë, nevojave të tyre shpesh nuk u jepet përparësi.

Pjesëmarrja e ulët e grave gjatë fazës së parë të procesit BP u kthye në një shqetësim për zyrtarët e bashkisë. Burrat dhe gratë kanë nevojë dhe e shfrytëzojnë mjedisin përreth në mënyra të ndryshme. Ka dallime të rëndësishme gjinore mes përparësive të tyre.

Zyrtarët e bashkisë kuptuan që zbatimi i një optike gjinore në procesin e buxhetimit pjesëmarrës do të ndihmonte të nxirrte në pah marrëdhëniet socio-ekonomike midis gjinive, varfërisë e përfshirjes sociale, si dhe nevojave e praktikave të ndryshme të shërbimeve, të përdorura nga gratë dhe burrat. Rezultatet do të demonstrojnë nevojën për pjesëmarrje të ekuilibruar, si të grave ashtu dhe të burrave, për të zhvilluar politika dhe shërbime lokale dhe për të akorduar burime të cilat u përgjigjen më mirë nevojave të grave dhe burrave. Si rrjedhojë, bashkia lidhi partneritet me UN Women për të rritur pjesëmarrjen e grave në buxhetim dhe për të futur një pikëpamje gjinore në procesin e BP.

Gjatë fazës së dytë të procesit të BP, e cila filloi më 2008ën, bashkia prezantoi një dimension të ri në proces, duke përfshirë aktivisht grupe grash.

Me mbështetjen e UN Women, administrata e bashkisë lidhi partneritet me dy organizata lokale për gratë, për të zhvilluar një analizë gjinore të buxhetimit pjesëmarrës në fillim të procesit. Ky ushtrim ndihmoi për të identifikuar pikat problematike në lidhje me pjesëmarrjen e burrave dhe grave, si dhe shërbeu për të nxjerrë në pah se si shpenzimet publike kanë sjellë përfitime për gratë dhe burrat në mënyra të ndryshme.

Pas kësaj analize, filluan veprimtaritë e BP me zyrtarët që përftonin një kuptim më të mirë sesi ta bënin projektin më përfshirës për gratë.

Procesi i buxhetimit pjesëmarrës në vetvete zakonisht zgjat 45 dite dhe menaxhohet nga bashkia. Qyteti ndahet në 23 lagje, ku mbahen mbledhje me qytetarët. Për të rritur pjesëmarrjen e komunitetit në takimet për BP, bashkia bëri një ftesë publike përmes mediave lokale. Gjithashtu, broshura me informacion rreth datës, orës dhe vendit shpërndahen me shumicë në çdo lagje, duke patur në vëmendje të vecantë vendet e frekuentuara nga gratë.

Qytetarët ftohen gjithashtu edhe përmes njoftimeve të shpërndara derë me derë ose përmes telefonit, nga personeli i bashkisë.

Organizatat ndihmëse në procesin e zhvilluar më parë, organizuan takime përgatitëse me qytetarët gra, me synimin për t'i përgatitur gratë më mirë për të shprehur shqetësimet e tyre gjatë takimeve zyrtare. Për më tepër, u bënë trajnime për zyrtarët e administratës së bashkisë të ngarkuar me menaxhimin e procesit të BP-se, sesi të inkurajonin pjesëmarrjen aktive të grave dhe të grupeve të tjera në nevojë. Falë kësaj përpjekjeje përgatitore nga organizatat lokale, më shumë gra morën pjesë në BP 2010 - 569 nga 1241 pjesëmarrës (45 për qind), përfshirë nga grupe të mënjanuara, si nëna me fëmijë me paaftësi sfiduese, gratë divorcuara, vejusha, të mbijetuara të dhunës në familje dhe gra romë.

Çdo lagje diskutoi dhe vendosi për çështjet prioritare të veta. Një komisioner- një përfaqësues për secilën nga 23 lagjet - u caktua në Komisionin E Buxhetimit përmes një procesi votimi.

BP 2010 shënoi një pikë kulmore në përfaqësimin e grave si komisionere - 11 nga 23, ose 8 më shumë se në vitin 2008. Këto 11 komisionere gra ushtruan votën e tyre në Komisionin Qendror, duke rritur kështu fuqinë vendimmarrëse të grave në përcaktimin e çështjeve prioritare për t'iu paraqitur Këshillit Bashkiak. Këto çështje prioritare më pas iu përcollën Këshillit Bashkiak, ku u mbajtën diskutimet për buxhetin; duke qene se mbledhjet ishin të hapura, kjo ishte një tjetër mundësi për gratë dhe burrat e Elbasanit për të marrë pjesë në to dhe për të monitoruar procesin.

BP-ja ka shërbyer gjithashtu për të rritur kuptimin nga ana e zyrtarëve të administratës së bashkisë mbi situatën socio-ekonomike në qytet dhe në cdo lagje, si dhe gatishmërinë e tyre për të kërkuar mendimin dhe gjykimin e qytetarëve për shërbimet e bashkisë.

Ky proces buxhetimi është kthyer në një qasje praktike për të vendosur kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët e Elbasanit.

Me mbështetjen e UN Women, Bashkia e Elbasanit ka krijuar një model të qëndrueshëm të ndjeshëm gjinor të buxhetimit me pjesëmarrje, i cili konsiston në:

- Ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e sensibilizimit të grave dhe burrave për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në të gjitha nivelet e procesit të BP (përmes mbështetjes së organizatave lokale);
- Trajnime orientuese për sensibilizimin dhe ndërtimin e besimit në mbështetje të pjesëmarrjes së grave në nivel qyteti (përmes mbështetjes së organizatave lokale);
- Ndërtim kapacitetesh të zyrtarëve të administratës, këshilltarëve të zgjedhur dhe komunitetit, për çështjet gjinore në proceset pjesëmarrëse dhe dhënien e shërbimeve (me ekspertë);
- Arritjen e ekuilibrit gjinor në të gjitha fazat e procesit të BP-së; dhe në rast se ka çekuilibër, gjetja e mekanizmave si kuotat gjinore etj, për të ndihmuar vendosjen e tij;
- Monitorimin nëse BP po mundëson pjesëmarrje të ekuilibruar gjinore dhe nëse procesi po përmbush nevojat e burrave dhe të grave (organizatat lokale dhe bashkia).

Rezultati i Iniciativës: Rritja e pjesëmarrjes së grave në buxhetimin me pjesëmarrje

Si rezultat i bashkëpunimit midis UN Women dhe organizatave lokale të shoqërisë civile, shkalla e pjesëmarrjes së grave arriti në 40 dhe 50 për qind. Gratë tani e shohin BP-në si një mundësi për të ndikuar vendimet e buxhetimit bashkiak. Më 2009ën prania e grave në procesin e buxhetimit pjesëmarrës solli një rritje të financimit të mini-projekteve të ndjeshme nga pikpamja gjinore, nga 14 (në 2007ën) në 24. Burimet e disponueshme bashkiake në mbështetje të barazisë gjinore ishin 4 herë më të larta krahasuar me vitin e mëparshëm. Me mbështetjen e UN Women, nga viti në vit, ka pasur një numër në rritje të grave aktive në procesin e BP (nga 10 deri 30 % në 2009, në 45 për qind në 2011), si dhe një numër në rritje të grave të zgjedhura në Këshill (nga 3 në 2009 dhe 2010 në 11 në 2011). Numri i projekteve të miratuara që marrin në konsideratë nevojat e grave gjithashtu është rritur.

Qendra Rinore “Epoka e Re” Fier

TITULLI I AKTIVITETIT: „ Krijimi i një qendre multifunksionale rinore në Fier”

Nismëtarët e iniciativës: OJF “Epoka e Re” dhe Bashkia Fier

Të rinjtë janë një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit shoqëror, një forcë drejtuese në reformat politike, ekonomike dhe sociale të vendit. Mundësia për të angazhuar të rinjtë, përmes forcimit të roleve të tyre në jetën publike dhe në qeverisje, tregon shkallën e demokracisë në institucionet dhe jetën publike në përgjithësi.

Organizata “Epoka e Re” punon me të rinjtë dhe për të rinjtë. Antarët e saj janë të rinj të qytetit të Fierit të moshës 14-29 vjeç. OJFja u krijua në vitin 2005 për të përmbushur nevojat e të rinjeve për t’u vetëorganizuar dhe për t’u bërë pjesë aktive e komunitetit. “Epoka e Re” beson në forcën e të rinjeve si agjentë për ndryshim në shoqëri. Synimi i organizatës është të ndihmojë dhe lehtësojë proceset e ndryshimit social, zhvillimin, progresin demokratik dhe përmirësimin e jetës së komunitetit përmes bashkëpunimit rinor. Qendra vepron në qytetin e Fierit përmes partneritetit me Pushtetin Lokal dhe organizata të tjera rajonale dhe më gjerë.

Duke marrë në konsideratë situatën aspak të favorshme për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e të rinjeve në jetën e qytetit, organizata rinore “Epoka e Re” Fier ndërmorri një fushatë për adresimin e çështjeve shqetësuese për të rinjtë në këtë qytet, për të forcuar zërin rinor dhe kërkuar qeverisje më të përgjegjshme dhe transparente, si dhe të rriste pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.

Kjo iniciativë u realizua në kuadër të Zgjedhjeve Vendore 2007, në të cilën Partnerët Shqipëri, në kuadër të programit Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri, mbështeti grupe të shoqërisë civile në shtatë qytete të Shqipërisë për organizimin e fushatave advokuese nën moton “Unë mbështes Qeverisjen e Mirë”. Organizata “Epoka e Re” në Fier ishte njëra prej tyre.

Iniciativa konsistoi në këto komponentë kryesore:

- 2006 - Krijimi I grupit Aktiv Rinor. (P. R.F.)
- 2006 -2007 - Trajnime dhe takime për përzgjedhjen e çështjes.
- 2007 - Ndërtimi i fushatës parazgjedhore ku rëndësi e vecantë iu kushtua fushatës promovuese të iniciativës dhe sensibilizimit me qëllim bashkimin e aktorëve të tjerë dhe rritjen e interesit ndër qytetarë (spote televizive, postera, fletpalosje, banera,
- 2007 - Takime individuale dhe forume me kandidatet për kryetarë bashkie Kontrata angazhimi për mbështetjen e çështjes me të gjithë kandidatet për kryetarë bashkie.
- 2007 -2008 – Monitorimi i çështjes pas zgjedhjeve / Takime me Kryetarin e Bashkisë e drejtues lokalë, debate në TV Lokale etj.

Si rezultat i përpjekjeve advokuese dhe lobuese të të rinjeve të angazhuar nga “Epoka e Re” dhe koalicionit të koordinuar prej tyre, u ngrit një qendër rinore në ambiente të ofruara nga Bashkia si dhe u morr angazhimi për bashkëpunimin lidhur me hartimin e një Strategjie Rinore për qytetin e Fierit, premtim i zyrtarizuar në praninë e medias dhe anëtarëve të Organizatës “Epoka e Re”.

Hartimi i Strategjisë Rinore për qytetin e Fierit, ishte një mjet i fuqishëm që do të rriste pjesëmarrjen e të rinjeve dhe kontributin e tyre në vendimmarrjen lokale. Hartimi i kësaj strategjie, u bë në kuadër të projektit “Të rinjtë në vendimmarrje – më shumë mundësi, më shume zgjidhje”.

Pas çertifikimit të tij si kryetar i bashkisë në vitin 2007, pas sjelles në vëmendje nga “Epoka e Re” të premtimit parazgjedhor, Z. Baftjar Zeqaj, ndërmoi hapa konkrete në përmbushjen e tij. U krijua grupi i punës me përfaqësues të bashkisë dhe anëtarë të “Epoka e Re”, dhe pas një pune disa mujore u përpilua, finalizua dhe miratua nga Keshilli Bashkiak “Stategjia Rinore për qytetin e Fierit”, një dokument zyrtar në fuqi. Gjatë përpilimit të saj, “Epoka e Re”, u asistua nga ekspertë të Partnerëve Shqipëri në të gjitha fazat, nga draftimi deri në finalizimin e saj.

Përpos miratimit të Stategjisë Rinore për qytetin e Fierit, qendra rinore “Epoka e Re” në bashkëpunim me Bashkinë ngritën Grupin Rinor Aktiv, i cili funksionon pranë Bashkisë si grup këshillimor për çështjet rinore, hartuan planin rinor lokal të veprimit si dhe krijuan hapsira për realizimin e përvitshëm të buxhetimit me pjesëmarrje për rininë.

Arritja më e fundit në 2013 pas një fushate të gjatë advokimi dhe lobimi, e “Epokes së Re” është ndërtimi i ambienteve të reja për një qendër rinore multifunktionale tashmë në Fier me kontributin e Bashkisë Fier, e cila do ti shërbejë të gjithë të rinjve për organizime aktiviteteve, ngritje kapacitetesh, aktivitete rekreative, debate e forume të hapura etj. Puna e organizatës dhe e aktivistëve të saj vijon me lobimin për zbatimin e planit të veprimit, si një çështje prioritare që do ti krijonte shumë hapsira të rinjve për punësim, trajnim, edukim profesional, kohezion social, etj.

4. REKOMANDIMET PËR AVANCIMIN E BASHKËPUNIT MES SHOQËRISË CIVILE DHE VETËQEVERISJEVE LOKALE NË MAL TË ZI DHE SHQIPËRI

- Nevojitet miratimi i ndryshimeve dhe i plotësimeve të rregullave me të cilat janë të rregulluar mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare në Shqipëri, në pajtim me standardet ndërkombëtare juridike si dhe me praktikën e mirë rajonale. Me ndryshime dhe plotësime të kornizës ligjore duhet në një mënyrë gjithëpërfshirëse të caktohen kushtet e përdorimit të mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare, obligimet e organeve lokal dhe afatet e veprimit të tyre;
- Inicimi i obligimit për komunat në Shqipëri që t’i caktojnë në buxhetet e veta linjat buxhetore që do t’i referohen shpërndarjes së mjeteve për financimin e projekteve të OJQ-ve;
- Harmonizimi i Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për projektet e OJQ-ve, Vendimit mbi mënyrën e pjesëmarrjes së popullsisë lokale, si dhe Rregullores mbi punën e Kuvendit në shumicën e komunave malazeze me zgjidhje të përmbajtur në Modelin e Vendimit mbi kriteret, mënyrën dhe procedurën e shpërndarjes së mjeteve për projektet e OJQ-ve, të Vendimit mbi mënyrën e pjesëmarrjes së popullsisë lokale, si dhe të Rregullores mbi punën e Kuvendit (Modelet e këtyre vendimeve i ka përgatitur Shoqata e Bashkive në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe CRNVO, me mbështetje financiare të OSBE-së);
- Marrja e Vendimit mbi themelimin e Këshillit për bashkëpunim me organizatat joqeveritare si dhe miratimi i Marrëveshjes mbi bashkëpunimin e Kuvendit komunal me organizatat joqeveritare, në pajtim me Modelet e vendimeve që i kanë përgatitur Shoqata e Bashkive, Ministria e Brendshme dhe CRNVO, në shumicën e komunave malazeze;
- Sigurimi i kushteve për punë më efektive të kontakt personave për bashkëpunim me OJQ në organe të qeverisjes lokale duke rregulluar kryerjen e punëve me Rregullore mbi organizimin dhe sistematizimin – Mali i Zi;
- Sigurimi i zbatimit të dispozitave të ligjeve të miratuara, si dhe akteve lokal me të cilët është rregulluar bashkëpunimi mes sektorit civil dhe vetëqeverisjes lokale – Mali i Zi dhe Shqipëria;
- Organizimi i trajnimeve për të punësuarit në administrata lokale – Mali i Zi dhe Shqipëria;
- Organizimi i ligjëratave, tribunave, tryezave të rrumbullakëta me qëllim të edukimit dhe nxitjes së qytetarëve dhe OJQ-ve për përdorimin më të gjerë të mekanizmave ekzistues për pjesëmarrjen qytetare në procesin e vendimmarrjes – Mali i Zi dhe Shqipëria;

- Organizimi i trajnimeve për kontakt personat për bashkëpunim me OJQ në tema të zbatimit të rregullave që rregullojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave joqeveritare në miratimin dhe implementimin e vendimeve në nivelin lokal – Mali i Zi dhe Shqipëria;
- Avancimi i statusit tatimor të OSHC përmes ndryshimeve të përshtatshme të Ligjit mbi tatimin e të ardhurave të personave juridik, me të cilat do të ishte zgjeruar lista e veprimtarive për qëllime të përgjithshme të dobishme, për të cilat shoqëritë tregtare dhe subjektet të tjerë juridik gëzojnë lehtësirat tatimore – Mali i Zi dhe Shqipëria;
- Avancimi i kapaciteteve të organizatave joqeveritare për pjesëmarrjen e kualifikuar në proceset e formulimit dhe zbatimit të politikave publike – Mali i Zi dhe Shqipëria;
- Avancimi i dijenisë së organizatave joqeveritare mbi përparësitë e formave të ndryshme të koalicioneve dhe platformave funksionale në nivelin lokal dhe në nivelin kombëtar që do të ishin marrë në mënyrë sistematike me advokim tek mbartësit e politikave publike.

5. BURIMET DHE LITERATURA

Literatura e përdorur:

- Qendra për zhvillim të organizatave joqeveritare, Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikave publike në Mal të Zi, 2010
- Milluşja Zhugiq, Manuali për qytetarët mbi mekanizmat e pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes në nivelin lokal
- Shoqata e bashkive e Malit të Zi, Manuali për modulën specifik – Përforcimi i përgjegjësisë dhe transparencës në nivelin lokal në Mal të Zi
- Arnstein, Sherry R. "A Ladder of Citizen Participation," Journal of the American Planning Association, Vol. 35, No. 4, July 1969, pp. 216-224
- Dahl, Robert, Polyarchy: Participation and Opposition. New Haven: Yale University Press, 1971
- USAID Projekti i zhvillimit të qëndrueshëm lokal, Me rëndësi është pjesëmarrja, Manuali për pjesëmarrjen e publikut në nivelin lokal, Beograd, 2011

Shembujt e praktikës së mirë

Internet faqet e dobishme:

- Internet faqja e Shoqatës së bashkive të Malit të Zi ku është botuar publikimi „Shembujt e praktikës së mirë në vetëqeverisje lokale në Mal të Zi në vitin 2012 <http://www.uom.co.me/?cat=6>
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë [http://www.parlament.al/web/Kushtetuta e Republikes se Shqiperise e perditesuar 1150 1.php](http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1150_1.php)
- Ligji mbi organizatat joprofitprurëse i Shqipërisë <http://www.partnersalbania.org/skedaret/1233137481-NGOalb.pdf>
- Ligji mbi qasjen e lirë në informacione <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligji%20Nr%208503%20Dat%C3%AB%2030-06-1999.htm>
- Zyra e Avokatit të Popullit të Shqipërisë http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=548
- Ligji mbi organizimin dhe mënyrën e funksionimit të vetëqeverisjes lokale http://www.moi.gov.al/drupal1/qeverisja/qeverisja_vendore.pdf
- Rowe and Frewer (2005) Science Technology Human Values Spring 2005 vol. 30 no. 2 251 <http://tacso.org/doc/doc0054.pdf>
- [http://www.parlament.al/web/Kushtetuta e Republikes se Shqiperise e perditesuar 1150 1.php](http://www.parlament.al/web/Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_e_perditesuar_1150_1.php)
- <http://www.partnersalbania.org/skedaret/1233137481-NGOalb.pdf>
- NGOs Sustainability Index 2010 – USAID www.tatime.gov.al
- http://www.qpz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2008/PDF-2008/64-2008.pdf
- http://www.tatime.gov.al/gdt/df_docum

LIGJI Nr. 8410, date 30.9.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë”

- <http://www.qpz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%208503%20Dat%C3%AB%2030-06-1999.htm>
- http://www.avokatipopullit.gov.al/?page_id=548
- http://www.moi.gov.al/drupal1/qeverisja/qeverisja_vendore.pdf

Legjislacioni kombëtar:

- Kushtetuta e Malit të Zi (“Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 01/07 nga data 25.10.2007);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale (“Fleta zyrtare e RMZ”, nr. 42/03, 28/04, 75/05, 13/06, “Fleta zyrtare e Malit të Zi”, nr. 88/09, 03/10 dhe 38/12);
- Ligji mbi qasjen e lirë në informacione (“Fleta zyrtare e Malit të Zi, numër 44/2012” nga data 09.08.2012);
- Ligji mbi referendum (“Fleta zyrtare e RMZ”, nr. 9/01);
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji mbi qasjen e lirë në informacione
- Ligji mbi organizatat joprofitprurëse i Shqipërisë
- Ligji mbi organizimin dhe mënyrën e funksionimit të vetëqeverisjes lokale

Legjislacioni Evropian:

- Karta Evropiane e vetëqeverisjes lokale <http://www.uom.co.me/wp-content/uploads/2010/05/Evropska-povelja-o-lokalnoj-samoupravi.pdf>;
- Ligji mbi organizatat joprofitprurëse i Shqipërisë

CIP – Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње

ISBN 978-86-85579-42-4

COBISS.CG-ID 22604048

ISBN 978-86-85579-42-4



9 788685 579424 >